



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë**

**Master profesional në "Punë Sociale e Avancuar" me profile:  
Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi i  
Institucionit të Arsimit të Lartë**

**" Universiteti i Tiranës "**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Stela Jorgji
2. Prof. Dr. Irena Nikaj

Shkurt 2023

**Për Programin e studimit Master profesional në "Punë Sociale e Avancuar" me profile:  
Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Punes dhe Politikës Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH nr. 513, datë 14.10.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/6 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2018-2019 – 68 të rregjistruar V.A 2019-2020 – 57 të rregjistruar V.A 2019-2020 – 56 të rregjistruar
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Programi Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsimit; Punë Sociale në Shëndetësi" ofrohet nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, FSHS/UT, si cikël i dytë studimesh.

Ky program starton me Urdhër nr. 513, datë 14.10.2011, të Ministrit të Arsisimit dhe Shkencës, në përputhje me nevojat e reja të departamentit, për të zgjeruar dhe plotësuar ciklin e studimeve bachelor, për studentët e punës sociale, sikurse edhe në përgjigje të nevojave të studentëve në tregun e punës.

Programi është hapur në vitin akademik 2011, në përputhje me nevojat e departamentit, për të zgjeruar dhe plotësuar ciklin e studimeve Bachelor, për studentët e punës sociale, por jo vetëm sikurse dhe në përgjigje të nevojave të studentëve për të pajisur me diploma dhe dokumente të vlefshme certifikimi.

Ky program studimi synon, të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit për të ndihmuar shoqërinë në tërësi; të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion; të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës.

Te diplomuarit në këtë program mund të ofrojnë kontributin e tyre profesional në tregun e punës në fushën e arsisimit dhe edukimit, në të gjitha nivelet e arsisimit parauniversitar.

Programi është strukturuar përputhur sistemit të Bolonjës, për ciklin përkatës të studimeve, por edhe mbështetur në nevojat dhe manovrat e tregut të punës kundrejt profesionistëve të punës sociale. Programi mësimor përmban 60 kredite dhe zhvillohet përgjatë një viti akademik.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi".

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për organizmin e ASCAL, dhe në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ASCAL ka përzgjedhur me Urdhër nr.77 dt. 01.07.2022, dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga instucioni për akreditimin e programit Master Profesional në "Punë Sociale e Avancuar me drejtim Arsim dhe Shëndetësi".

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Stela Jorgji dhe Prof. Dr. Irena Nikaj. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Pas komunikimit nga ASCAL, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët studiuuan dhe vlerësuan dosjen e programit, raportin e vetëvlerësimit dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, ngarkuar në sistem. Ekspertët mbas njohjes dhe vlerësimit të gjithë dokumentacionit, bënë përgatitjet e nevojshme, përpiluan pyetjet dhe evidentuan paqartësitë e tyre, si dhe u caktuan nëpërmjet ASCAL-it datat e vizitave në institucion. Vizita në institucion u krye në datat 20-21 Korrik 2022. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i Fakultetit të Shkencave Sociale, UT, u angazhua për t'iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 31.01.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/18 Prot., datë 31.01.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1415/16 Prot., datë 03.02.2023.

**GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin, sqaron si vijon:**

**Fusha 3: Mesimidhenia, Mesimnxenia, vleresimi dhe kompetencat  
Standardi 3.1, Kriteri 1**

**Komente nga GVB:** Udhëzuesi në nivel institucional, dedikuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, në bazë të fushës së studimeve që ofron MPPSA-ja, është një domosdoshmëri që është evidentuar e diskutuar edhe nga ana jonë në takimet në departament dhe do të jetë e projektuar në strategjinë vijuese të DPPS dhe atë të programit të studimit.

Departamenti është mbështetur në rregulloren e UT-së dhe udhëzimet e posaçme, për përdorimin e platformës Teams, funksionale për periudhën e pandemisë Covid 19-të dhe studimeve online, platformë e cila praktikisht është e funksionale të përdoret në çdo kohë.

Mbështetur edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 departamenti ka diskutuar vazhdimisht nevojën e krijimit të hapësirave të realizimit të mësimdhënies duke shfrytëzuar teknologjinë digjitale dhe platformat online, për të ndihmuar gjithnjë studentët në vijimin e studimeve, por ende mungon dakordësia nga ministria e linjës për çështjen në fjalë.

Stafi i DPPS ka fituar kualifikimet e nevojshme në evente të ndryshme shkencore, trajnime, projekte etj., për të përdorur instrumente që lehtësojnë mësimdhënien e mesimnxënien, për vetë stafin dhe për studentët. Metodatat inovative shkojnë përshtat me specifikat e programit të studimit dhe përmbajtjen e kurrikulave dhe udhëzimet për zhvillimin e tyre administrohen në syllabuset e lëndëve. Aktualisht modele të zhvillimit të mësimdhënies që nxitin pavarësinë e mendimit dhe shprehive profesionale, janë loja me role, prezantimet e projekteve të detyrave në auditore, ku studentët diskutojmë dhe vlerësojnë veten dhe punimet e njëri-tjetrit, zhvillimi i orëve të veçanta në bashkëpunim me institucione të rëndësishme, ku përballen dijet teorike bashkëkohore me protokollat e praktikave aktuale të punës në çështje të caktuara. Stafi i DPPS-së është trajnuar në aksesimin dhe përdorimin e platformës Moodle dhe EMS në kuadër të projektit Task dhe po punon në nivel institucional të gjejë mundësinë për përdorimin e tyre, sipas një rregulloreje të unifikuar, në ndihmë të lehtësimit të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në të gjitha nivelet dhe programet e studimit. Kjo rregullore do të ndihmojë dhe do të ndihmojë dhe do të mbështesë pedagogët dhe studentët në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit.

DPPS-ja zotëron kapacitetet e nevojshme në burime njerëzore dhe financiare për të realizuar, inovacion, prandaj ka propozuar edhe buxhetimin për blerjen e programeve të dedikuara kërkimit shkencor, të aksesueshëm edhe për studentët. Koordinatorin e programit të MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të FSHS-së dhe DPPS-së, po punon për të nxitur dhe përshpejtuar procesin.

GVB-ja shpreh dakordësinë me sugjerimet e GVJ-së dhe deklarohet me angazhimin e përbushjes së plotë të tyre në vijimësi, duke forcuar edhe më shumë kapacitetet e MPPA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi.

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse është thjesht një sugjerim nga ana jone për hartim në të ardhmen të një udhëzuesi.

#### **Fusha 1: Ofrimi i Programeve të Studimit.**

##### **Standardi 1.3. Kriteri 7, faqe 9.**

**Komente nga GVB:** Realizimi i këtyre trajnimeve është mundësuar përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes financiare të partnerëve të departamentit, si UNICEF, Terre des'Homes, etj. Trajnimet janë realizuar nga stafi i DPPD-së rregullisht, me prezencë fizike në auditore. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, praktikat e trajnimeve janë transferuar në platforma elektronike që vijojnë të jenë të aksesueshme me web, seminare apo trajnime online, siç është platforma online: <https://sociale.al/rreth-nesh/>

Lutemi grupit të GVJ-së të aksesojë platformën e sipërcituar, për të verifikuar listën e trajnimeve, të dedikuar veçanërisht të diplomuarve të këtij programi.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me Urdhërin e Punonjësit Social, edukimi në vazhdim për profesionistët e këtij profesioni të rregulluar me ligj, do të vijojë me trajnime specifike të fushës, në kuadër të licensimit të profesionistëve.

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse aktualisht pervec trajnimeve nuk ofrohen module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin ne perputhje me standardin e kerkuar.

#### **Fusha 1: Ofrimi i Programeve të Studimit.**

Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi 1.5. Kriteri 5, faqe 11.**

**Komente nga** Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, në përbushje të misionit të tij për mësimdhënie dhe aftësim për gjatë gjithë jetës, nuk ka ndërtuar vetëm programet e edukimit, siç është edhe MPPSA, por ka vijuar edukimin dhe mbështetjen e studentëve të diplomuar dhe punësuar në institucionet që ofrojnë shërbime sociale, duke organizuar në mënyrë të vijueshme trajnime profesionale, rritje kapacitetesh dhe riorganizim shërbimesh, edhe në drejtimet punë sociale dhe në arsim.

Modele të zhvillimit të mësimdhënies që nxitin pavarësinë e mendimit dhe shprehive profesionale, janë loja me role, prezantimet e projekteve të detyrave në auditore, ku studentët diskutojnë dhe vlerësojnë veten dhe punimet e njëri-tjetrit, zhvillimi i orëve të veçanta në bashkëpunim me institucione të rëndësishme, ku përballen dijet teorike bashkëkohore me protokollat e praktikave aktuale të punës në çështje të caktuara. Stafi i DPPS-së është trajnuar në aksesimin dhe përdorimin e platformës Moodle dhe EMS në kuadër të projektit Task dhe po punon në nivel institucional të gjejë mundësinë për përdorimin e tyre, sipas një rregulloreje të unifikuar, në ndihmë të lehtësimit të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në të




gjitha nivelet dhe programet e studimit. Kjo rregullore do të ndihmojë dhe do të ndihmojë dhe do të mbështesë pedagogët dhe studentët në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit.

DPPS-ja zotëron kapacitetet e nevojshme në burime njerëzore dhe financiare për të realizuar, inovacion, prandaj ka propozuar edhe buxhetimin për blerjen e programeve të dedikuara kërkimit shkencor, të aksesueshëm edhe për studentët. Koordinator i programit të MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të FSHS-së dhe DPPS-së, po punon për të nxitur dhe përshpejtuar procesin.

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** sepse nuk ofrohen evidenca konkrete dhe te dhena per trajnime profesionale të mëtejshme **për studentët e diplomuar** në bashkërendim me punëdhënësit.



7  


**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master profesional në "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi"**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" i ofruar nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, FSHS, UT, përmban lëndë dhe kurrikula të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Sikurse edhe në objektivat e programit të studimit ( <i>Referenca Strategjia e Zhvillimit të UT (2018-2023)</i> ), programi i studimit Masteri Profesional në "Punë Sociale e Avancuar" (2 drejtim arsim/shëndetësi) është në përputhje me misionin dhe vizionin e Institucionit si dhe në përputhje me interesat kombëtare. Universiteti i Tiranës është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi në përputhje tërësojë me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Në Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij "Misioni", deklarohet se <i>"Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut."</i>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, Statutin e UT si dhe Planin strategjik i Institucionit ku përcaktohet se Universiteti i Tiranës synon, të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë, për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky synim gjen shprehje në dokumentin <i>"Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023"</i> , seksioni <i>"Mësimdhënia dhe Studentët"</i> , ku mes të tjerash, theksohet se <i>"Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin e konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor"</i> ,
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet është hartuar me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Tiranës ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua edhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në ditët e vizitave në institucion. Programi i Studimit, është përshtatur me <i>Strategjia e Zhvillimit të UT (2018-2023)</i> , duke arritur objektivat e vëna në këtë strategji.



	Ky program studimi synon, të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore; të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit për të ndihmuar shoqërinë në tërësi; të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion; të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu aktual i punës. Per me tepër në statutin e UT (2018), Neni 5 i tij "Misioni", ku mes të tjerash, IAL delaron se <i>"Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale"</i> (fq.3);		
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" i ofruar nga Departamenti i Punes dhe Politikës Sociale, FSHS, UT, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e tregut të punës për këtë lloj profesioni si në nivel lokal ashtu dhe në nivel kombëtar. Të diplomuarit në këtë program mund të ofrojnë kontributin e tyre profesional në tregun e punës në fushën e arsimit dhe edukimit, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Referenca 3.5 Strategjia e zhvillimi te programit te studimit MPPSA (fq 3)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" i ofruar nga Departamenti i Punes dhe Politikës Sociale, FSHS, UT, është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të Universitetit të Tiranës, <i>Strategjia e Zhvillimit te UT (2018-2023)</i> ,  Ky program është hartuar dhe ju ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, me drejtimet strategjike të zhvillimit të UT-së si dhe është në përputhje me planin strategjik institucional sipas prioritetëve të vendosura e të sipërpërmendura.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në analizën e dokumentave strategjikë të institucionit, Statuti, Plani Strategjik i Institucionit, Rregullore e programit të studimit MPPSA, Plani mësikor i programit të studimit MPPSA, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit MPPSA, si dhe nga Rregullorja e FSHS-së dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.  Evidenca 1. 1.2. Statuti UT-së; Evidenca 1. 1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2018-2023; Evidenca 2. 2.4. Rregullore e FSHS-së Evidenca 3. 3.6. Rregullore e programit të studimit MPPSA;

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

9

	Evidenca 4. 4.2. Plani mësimor i programit të studimit MPPSA Evidenca 3. 3.5. Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit MPPSA.		
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt. 24.01.2018. Programi ofrohet nga Departamenti Punes dhe Politikave Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe është në përputhje me fushat e drejtimet akademike si me Strategjinë e Zhvillimit të UT-së gjithashtu në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.  Evidenca 1.1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2018-2023 Evidenca 3. 3.2. Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Shqyrtimi i dokumentave bazë dhe vizita në institucion e GVJ, konfirmon se programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është hartuar në përputhje me interesat kombëtare dhe trendet globale të zhvillimit lokal e kombëtar dhe është realizuar në përputhje dhe i udhëhequr nga Strategjia e Zhvillimit të UT-së në nivel institucioni. Ky plan strategjik, ashtu siç shprehet është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit, pasi reflekton në mënyrë të vazhdueshme përmirësime në planet mësimore, programet e lëndëve, duke reflektuar ndryshimet në strategjinë kombëtare të zhvillimit, kombinuar edhe me trendet ndërkombëtare.  Evidenca 1. 1.4. Strategjia e Zhvillimit të UT-së, 2018-2023 Evidenca 2. 2.3. Strategjia e Zhvillimit të FSHS-së Evidenca 3. 3.2. Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultojnë se programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" ka si mision të rrisë standardet dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale përgatitjen e profesionistëve të fushës synon t'u ofrojë studentëve thellimin e njohurive specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës me standartet më të larta akademike bashkëkohore duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve të vazhdueshme të ekonomisë.  Programi synon të përgatisë studentët me metodat praktike dhe koncepte të cilat avancojnë në fuqizimin dhe mirëqënien e individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve duke i ngritur ata në nivel profesionistësh të punës sociale të cilët do të jenë të përgatitur të shërbejnë me kompetencë në sistemin arsimor dhe shëndetësor.



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim tregu mbështetur në një plan të qartë për përgatitjen e studentëve profesionistë të së ardhmes në fushat respektive të studimit që fakulteti ofron. Universiteti, fakulteti dhe departamenti ndërmarrin nisma të përbashkëta dhe në mënyrë të pavarur mbi studimin e tregut të punës për studentët e tij të diplomuar.</p> <p>Gjithashtu institucioni kryen studime mbi nevojat e tregut lokal e Kombëtar të punës për programet e studimit duke mbledhur të dhëna mbi punësimin e studentëve pas diplomimit dhe sektorët e punësimit të fushës.</p> <p>Evidenca 4. 4.14. Të dhëna përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit. Studim Tregu (Problematika e tregut të punës për studentët që diplomohen në Universitetin e Tiranës), maj 2018</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" ka objektiva formues të përcaktuar qartë që konsistojnë në rritjen e kapacitetit, të aftësive dhe të profesionalizmit të studentit që ose është i punësuar ose do të hyjë pas këtij programi në tregun e punës. Përmbajtja e programit mësimor me lëndë të fushës si: "Paradigmat e sjelljes njerëzore", "Çështjet bashkëkohore dhe filozofia e punës sociale", "Komunikimi dhe ndryshimi i sjelljes", "Menaxhimi i projekteve sociale", "Puna sociale në arsim", "Mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijës", "Shërbimet e punës sociale në shëndetësi", "Puna sociale dhe aftësia e kufizuar" etj., si dhe praktikrat e shumta synojnë përgatitjen e studentëve me dije të nivelit akademik, studimor dhe kërkimor që u përgjigjen nevojave të njohurive në fusha specifike të njohjes së praktikës së punës sociale në sistemin arsimor dhe shëndetësor në të gjitha nivelet për përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Referenca 4.2 Plani mesimor i programit MPPSA</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar RVB, programi është hartuar duke ju referuar nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar sikurse ai është ndërkombëtarisht konkurrues në elementët përbërës së tij.</p> <p>GVJ gjatë takimeve me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit sikurse edhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, u evidentua se programi i studimit është bazuar në kurrikula të ngjashme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE pasi është konceptuar me qëllim jo vetëm pasjen e një programi bashkëkohor dhe modern, cilësor dhe inovativ, por edhe në sigurimin e mobilitetit, lehtësimin e procesit të transferimit të studimeve, apo punësimin e ardhshëm të studentëve në tregun ndërkombëtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale janë të hartuara, konceptuara dhe zbatohen në qasje me rregullat dhe parimet e Hapesirës Europiane të Arsimit të Lartë.</p> <p>Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE. Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli European.</p>


	Suplementi i diplomës ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas sitemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve.								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Referuar dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara rezultojnë se praktika profesionale realizohet pranë institucioneve publike, apo në sektorin privat të nivelit lokal apo kombëtar. Praktikave profesionale realizohen në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe ato individuale të studentit. Për këtë qëllim shërben dhe <i>Udhëzuesi i Praktikave</i> , i cili parashikon në mënyrë të qartë modalitetet dhe afatet kohore të kryerjes së praktikave mësimore, procesin e organizimit të praktikave, udhëheqësit e praktikave, mënyrën e vlerësimit të tyre. Evidenca 4. 4.2.Plani mësimor i programit të studimit MPPSA Evidenca 4. 4.3. Programet mësimore të lëndëve të studimit MPPSA Evidenca 4.4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit MPPSA								
<b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi” ofrohet në gjuhën shqipe. Kjo praktikë nuk aplikohet në këtë program. Programi është ofruar në gjuhën shqipe përgjatë gjithë kohës së funksionimit të tij përveç leksioneve të hapura me profesorë të ftuar. <i>GVJ sugjeron se në përmbushje të objektivit të programit për të përgatitur profesionistë në këtë fushë që të jenë konkurrues në tregun ndërkombëtar, Institucioni mund të rishikojë mundësinë për të ofruar lëndë në gjuhën angleze; kjo do të ishte një mundësi përthithje e studentëve të huaj.</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi aktual, është vënë në zbatim bazuar në hapësirat ligjore përkatëse, të parashikuara në ligjin 80/2015, Statutin e UT-së, Rregulloren e UT-së. Në vitin akademik 2018-2019 numri i studentëve të rregjistruar është 69 studente; viti akademik 2019-2020 numri i studentëve të rregjistruar është 58 studentë; dhe viti akademik 2020-2021 numri i studentëve të rregjistruar është 56 studentë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Nuk përmbushet		X		
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Nuk përmbushet						
	X								

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstatoi se FSHS, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Stafit i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar, në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe komunikimi me zyrën e burimeve njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi.  Për ofrimin e këtij programi, DPSS ka angazhuar staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shumica e të cilëve zotërojnë tituj dhe grada shkencore në specialitetin që përputhet me fushën specifike të programit të studimit.

	Referuar dokumentit <i>RVB si edhe Tabelës ne kete program studimi jane angazhuar 6 (Personel akademik Efektiv) PAE dhe 6 (Personel Akademik me Kontratë) PAK</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Në "Strategjitë e zhvillimit të FSHS, 2018-2023", FSHS, njësia kryesore ku ofrohet programi i studimit MPPSA, deklaroi se vizioni i saj është "të jetë një institucion elitare në arsimin e lartë, vatrë e mësimdhënies me standardet evropiane, qendër e rëndësishme e kërkimit shkencor në fushat sociale në Shqipëri dhe në Rajon, ofruar shërbimesh për komunitetin, agjent i ndryshimit të shoqërisë shqiptare"</p> <p>Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Ky program referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 ETC dhe kohëzgjatje 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015.</p>		
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, si njësi bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Referuar raportit GVB parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kadri ligjor për arsimin e lartë; Statuti dhe rregulloret të Universitetit të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e punonjësve social.</p>		
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i ciklit të dytë Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet përfundimisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njësi baze përgjegjëse është Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, me detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti mbulon me staf të kualifikuar lëndët / modulet e programit, dhe staf të jashtëm. Përveç drejtuesit të Departamentit i cili kishte një rol kryesor në koordinimin e programit, Kordinatori i programit luan rolin e një ndërmjetësi midis studentëve dhe institucionit që ndjek përmbajtjen dhe cilësinë e ekzekutimit të programit të studimit. I gjithë procesi, pra për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit u konstatua që bëhet në mënyrë të kordinuar nga të gjitha hallkat përgjegjëse dhe drejtuese e

	strukturës (organigrames) së FSHS. Analiza e vazhdueshme e punës, pasqyrohet në raportet vjetore të punës së departamentit në FSHS-së, si dhe në raportet e sigurimit të cilësisë.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët si dhe stafin, GVJ konstatoi se Universiteti i Tiranës, FSHS dhe Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme me institucione arsimore vendase dhe të huaja dhe si partner në projekte ndërkombëtare të financuara në kuadër të programeve të Komunitetit Evropian si Erasmus+, Gradua, Mevlana të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit. FSHS, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes “ <i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale</i> ” (materiali 3.17, e-ASCAL) se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj., për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve të cilët ndjekin programet e studimit të ofruara nga FSHS, duke përfshirë edhe ata që ndjekin programin e studimit Referenca 3.17 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale.
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij program studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, ajo shoqërohet me 10 kredite (ECTS), dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. Universiteti i Tiranës, FSHS, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve Referenca 3.17 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale. Bazuar në dokumentacion por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar dhe funksionale.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Tiranës, FSHS dhe institucioneve të ndryshme dhe organizatat për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të veçanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni ku studentët kryejnë praktikën është e lidhur me fushën e studimit. Referenca 3.17 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<i>GVJ evidentoi se Institucioni nuk ofron trajnime profesionale specifike apo te dedikuara për studentët e diplomuar ndër vite, mbas diplomimit të tyre.</i> Sipas raportit të GVB Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale ofron, sinjalizon dhe njofton të diplomuarit për mundësi trajnime të mundësuar nga organizata ndërkombëtare, kombëtare e lokale. Thirrje për trajnime/programe të cilat janë publikuar në web faqen e FSHS-së dhe faqet në rrjetet sociale të Departamentit. <i>Raportet dhe lidhjet e njësisë bazë me ish të diplomuarit dhe me karrierën e tyre mbas diplomimit gjithsesi janë aktive.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në	Sipas dokumentacionit departamenti me ane te analizës të punës vjetore përgatit raporte ku evidenton përfitimet/arritjet nga bashkëpunimi me aktorët të ndryshëm si në aspektin e praktikave profesionale ashtu edhe atë të kërkimit shkencor dhe projekteve studimore.



funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Evidenca 2. 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studentët përfitojnë 60 ECTS.</p> <p>Kurrikula është e ndërtuar në përputhje me kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor dhe Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)<sup>1</sup>.</p> <p>Programi i studimit është me kohë të plotë, me 60 kredite dhe me 1 vit akademik kohëzgjatje totale. Lëndët e programit janë të shpërndara në 2 semestra. Në semestrin e parë, zhvillohen 4 lëndë të formimit bazë dhe 1 lëndë e formimit karakterizues, me nga 5 kredite (ECTS), ndërsa në semestrin e dytë, zhvillohen 3 lëndë karakterizuese, me nga 5 kredite (ECTS), praktika profesionale me 10 kredite (ECTS). Ndërkohë, që punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm i formimit, janë vlerësuar me 10 kredite (ECTS). Organizimi në lëndë dhe vlerësimi në kredite pasqyrohet në Planin Mësimor.</p> <p>Evidenca 3.3.6 Rregullore e Programit të Studimit Masteri Profesional në "Punë Sociale e Avancuar" (dy drejtime Arsim/Shëndetësi)</p>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>Lëndët synojnë vecanërisht në përgatitjen e profesionistëve me metodat praktike dhe koncepte të cilat avancojnë në mirëqënien e individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve duke i ngritur ata në nivel profesionistësh të punës sociale të cilët do të jenë të përgatitur të shërbejnë me kompetencë në sistemin arsimor dhe shëndetësor, duke u dhënë mundësi studentëve të punësohen si</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-specialistë të shërbimit psiko-social në shkolla;</li> <li>-specialistë të shërbimit psiko-social në njësitë e kujdesit shëndetësor, etj.</li> </ul> <p>Evidenca 4. 4.3. Programet mësimore të lëndëve të MPPSA</p>
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" nëpërmjet përmbajtjes së programeve të

<sup>1</sup> Evidenca 3.3.10. Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit MPPSA

<p>përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>lëndëve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave profesionale dhe eksperiencave të studentëve jashtë fakultetit, synon që t'u japë studentëve njohuri të avancuara akademike dhe shprehi praktike në fushën përkatëse të studimit.</p> <p>Evidenca 3.3.6 Rregullore e Programit të Studimit Masteri Profesional në "Punë Sociale e Avancuar" (dy drejtime Arsim/Shëndetësi)</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se programi MPPSA, synon që përveç aftësive dhe kompetencave teorike dhe profesionale në fushën e përgjithshme të edukimit dhe mësimdhënies, të pajisë studentët me njohuri specifike profesionale dhe më të avancuara të punës sociale, duke u fokusuar në aftësi të veçanta që iu duhen këtyre profesionistëve të ardhshëm, për të punuar direkt me përfituesit e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore. Ky program studimi ka për qëllim të pajisë me njohuri teorike dhe praktike të diplomuarit në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 4. 4.3. Programet mësimore të lëndëve të MPPSA</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, "Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë", Pika 2 e tij, përcakton se "Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".</p> <p>Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Pika 2, shprehet se: <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>d) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>dh) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>e) planin mësimor;</li> <li>e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</li> <li>ë) programin lëndor (Syllabus-et);</li> <li>f) profilin e programit;</li> <li>g) diplomën dhe suplementin</li> </ul> <p>Programi i studimeve të ciklit të dytë MPPSA përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është e përbërë nga:</p> <p>Lëndë bazë;</p> <p>Lëndë karakterizuese;</p> <p>Lëndë plotësuese, praktikë mësimore;</p> <p>Detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Në kategorine A, lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 33.3%</p> <p>Në kategorine B, lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore 33.3%</p> <p>Në kategorine D, lëndë plotësuese –praktika profesionale 16.6%</p> <p>Në kategorine E, detyrime përmbyllëse 16.6%</p> <p>Format e organizimit të orëve për realizimin e programit mësimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-mësimi në auditor (leksion, seminare);</li> <li>-studimi individual (studime, detyra apo projekte, përgatitja për provime, përgatitja për tezën e diplomës, etj.)</li> </ul>





	-veprimtaritë praktike profesionale, si praktika jashtë auditorit, pranë institucioneve publike dhe jopublike dhe OJQ Evidenca 4. 4.2. Plani mësimor i programit të studimit MPPSA						
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Referuar dokumentacionit sipas programit mësimor të lëndëve të programit të studimit MPPSA, praktika profesionale për programin MPPSA ka 10 kredite / ECTS, pra, një detyrim prej 250 orë pune për studentin. Evidenca 4. 4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit MPPSA						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi", ofrohet nga Departamenti i Punes dhe Politikave Sociale, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Sipas hapave të përshkruara në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017", ASCAL ka ushtruar detyrimin e tij, ligjor, pas pranimit të kërkesës së UT/FSHS/DPPS për akreditim të programit të studimit përkatës, duke shqyrtuar paraprakisht përputhshmërinë ligjore të kërkesës së akreditimit. Në fokus të kësaj procedure ka qënë verifikimi i akteve ligjore të funksionimit të institucionit të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në rastin konkret, kur aplikimi ka rezultuar i saktë, ASCAL ka vijuar me kontrollin e përputhshmërisë ligjore të UT për strukturën akademike të njësive kryesore/njësive bazë, stafit akademik, dhe akteve nënligjore të funksionimit, organizimit dhe akreditimit.</p> <p>Në përfundim ASCAL, në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit, ka konsideruar se aplikimi është në përputhje me aktet ligjore dhe procedurën e akreditimit, dhe ka vijuar me përcaktimin e periudhës së vlerësimit të jashtëm për akreditim të programit përkatës.</p> <p>Departamenti i Punes dhe Politikave Sociale, e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Në Ligjin nr. 80/2015 të AL, Neni 23, "Fakulteti", përkufizohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë.</li> <li>2. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.</li> </ol>

	<p>FSHS i cili ofron programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, të përshkruara edhe në Statutin të UT-së (2018), Neni 11 “Njësitë përbërëse të UT”, ku shprehimisht përcaktohet se “FSHS përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë;</li> <li>2. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale;</li> <li>3. Departamenti i Filozofisë;</li> <li>4. Departamenti i Sociologjisë;</li> <li>5. Departamenti i Shkencave Politike.</li> </ol>
	<p>Sipas Rregullores së FSHS (2018), Neni 9, “Organizimi akademik”, përshkruhet se FSHS është e organizuar si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Asambleja e personelit akademik</li> <li>2. Organet kolegjiale</li> </ol>
	<p>Dekanati është organ iolegjial që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Dekani</li> <li>b) Zëvendësdekanët</li> <li>c) Administrator i njësisë kryesore</li> <li>d) Drejtuesit e njësive bazë</li> </ol> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Komisioni i doktoraturave</li> <li>4. Autoritetet drejtuese       <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Dekani</li> <li>b) Zëvendësdekani</li> <li>c) Drejtuesi i departamentit</li> </ol> </li> <li>5. Njësitë bazë       <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Departamenti i Filozofisë;</li> <li>b) Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë;</li> <li>c) Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale;</li> <li>d) Departamenti i Sociologjisë;</li> <li>e) Departamenti i Shkencave Politike.</li> </ol> </li> </ol> <p>Nga dokumentacioni dhe takimet e zhvilluara GVJ konstaton se Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, është organizuar me një strukturë që përmbush kërkesat e programit të studimit Master profesional “Punë Sociale e Avancuar” me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi”</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Njësia përgjegjëse gjatë tre viteve akademike të fundit për këtë program studimi në strukturën e tij ka personel akademik gjithsej, 21 pedagogë efektivë, nga të cilët një me titull Profesor dhe 13-të me titullin Profesor i Asociuar, si dhe personel ndihmës akademik. Personeli akademik, përbëhet edhe nga personel akademik i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar, si dhe personel akademik i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme.</p> <p>22 personel akademik me kohë të plotë nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 12 Profesor i Asociuar, 7 Doktor dhe 2 Asistentë Lektore me MSC.</p> <p><i>Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi i angazhar për këtë program studimi është 6 PAE dhe 6 PAK.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Sipas Ligjit nr. 80/2015 të AL, Neni 57, “Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”, përcaktohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ.</li> </ol>

	<p>2. Personeli i institucioneve të arsimit të lartë mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.</p> <p>Referuar Nenit 25 të këtij Ligji, "Departamenti", pika 4, përcaktohet se "Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik".</p> <p>Njesia përgjegjëse gjate tre viteve akademike të fundit per kete program studimi në strukturën e tij ka personel akademik gjithsej, 21 pedagogë efektivë, nga të cilët një me titull Profesor dhe 13-të me titullin Profesor i Asociuar, si dhe personel ndihmës akademik. Personeli akademik, përbëhet edhe nga personel akademik i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar, si dhe personel akademik i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme.</p> <p>22 personel akademik me kohë të plotë nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 12 Profesor i Asociuar, 7 Doktor dhe 2 Asistentë Lektore me MSC.</p> <p>Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi i angazhar per kete program studimi është 6 PAE dhe 6 PAK.</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara GVJ rezultuan se Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale angazhon personel akademik për realizimin e praktikave mësimore, ndërkohë supervizimi në praktikë në institucione kryhet nga specialistët e tyre sipas marrëveshjes të Fakultetit me Institucionin.</p> <p>Në kategorinë e personelit ndihmës akademik të departamentit, bën pjesë personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, në të cilën bën pjesë sekretaria mësimore, e cila krijon, mirëmban, administron dhe vë në dispozicion dokumentacionin e procesit mësimor, si dhe personeli ndihmës mësimor i departamentit.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Rregulloja e Programit Master Profesional e përcakton rolin e koordinatorit dhe për këtë program studimi ka caktuar një person përgjegjës në rolin e kordinatorit të programit të studimit. Roli i kordinatorit konsiston në koordinimin e programit, analizën e të dhënave statistikore, kontrollin raportimin dhe komunikimin me studentët për problemet e tyre.</p> <p>Evidenca 3. 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale Evidenca 3. 3.6. Rregullore e programit të studimit MPPSA</p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Kordinatori i programit është në kontakt të drejtpërdrejtë me përgjegjës të Departamentit në lidhje me ecurinë e programit gjë të cilën GVJ e konfirmoi nga të dyja palët komunikuese.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X
<p><b>Standardi II.3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>			
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>		


<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, kurrikula e programit të studimit; plani mësimor; programet mësimore të lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese. Në planin mësimor të programit të studimit përcaktohen lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarisë formuese si edhe në semestra si dhe kreditet përkatëse.</p>																		
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën si më poshtë:</p> <p>Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime)</li> <li>- studimi individual (kërkimi, studimi, punim i eseve, detyrave apo projekteve, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës)</li> </ul> <p>Veprimtaritë formuese, sipas kategorisë "Shtojca", në VKM nr. 41/2018, përcaktohen në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="651 846 1372 1339"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi i komponentit mësimor</th> <th>Master profesional</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</td> <td>5% - 10% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore</td> <td>30% - 45% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje</td> <td>20% - 30% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale</td> <td>10% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>10% - 20% (kredite)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Shqyrtimi i përmbajtjes së Planit Mësimor të programit 2018-2019 MPPSA, tregon se lëndët rezultojnë, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese nga A në E të përcaktuara në VKM nr .41/2018, si dhe në vite e semestra dhe me kreditet përkatëse.</p> <p>Lidhur me shpërndarjen e lëndëve dhe praktikës sipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se:</p> <p>Mbeshtetur në dhënat e paraqitura në dokumentin planit mësimor të programit të studimit MPPSA viti akademik 2018-2019 janë analizuar, organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41/2018, për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit MP dhe konkretisht kemi kete shperndarje te lendeve:</p> <p>Në kategorine A, lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 33.3%</p> <p>Në kategorine B, lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore 33.3%</p> <p>Në kategorine D, lëndë plotësuese –praktika profesionale 16.6%</p>	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Master profesional	A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	5% - 10% (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	30% - 45% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	20% - 30% (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10% (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	10% - 20% (kredite)
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Master profesional																	
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	5% - 10% (kredite)																	
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	30% - 45% (kredite)																	
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	20% - 30% (kredite)																	
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10% (kredite)																	
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	10% - 20% (kredite)																	



	Në kategorine E, detyrime përmblylëse 16.6% Evidenca 4. 2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" i riorganizuar në 60 kredite: Mësimi organizohet gjatë një viti akademik, me 2 semestra, të organizuar secili në 15 javë mësimore. Çdo semester ka 25 kredite me mbylljen në fund të mikrotezes me 10 kredite. Totali i orëve që zhvillon studenti në auditor dhe si punë e pavarur, konvertohet në 1 ECTS = 25 orë mësimore punë e studentit. Evidenca 4. 2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor i programit të studimit të Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" pasqyron në mënyrë të detajuar informacionin në lidhje me shpërndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, detyrimin për frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit, për secilin element, sipas sistemit të vlerësimit të integruar. Veprimtaritë formuese, që e karakterizojnë programin, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: 1. mësimi në auditor ku përfshihen leksionet, seminarët, detyra kursi, forma të kontrollit të vazhdueshëm. 2. përgatitje për provime. 3. përgatitje për provimin e përgjithshëm të formimit /tezhën e diplomës. 4. veprimtari të tjera, si praktika profesionale. Ndarja e orëve mësimore në auditor për leksione, seminare dhe praktika profesionale, është i përcaktuar në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë. Krediti shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore dhe një kredit korrespondon me 25 orë mësimore, punë të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer nga një student gjatë vitit akademik të studimit të programit master profesional, është 60 kredite ose 60 x 25 = 1,500 orë mësimore punë të studentit, të cilët përfshijnë orë në auditor dhe orë punë të pavarur të tij. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, detyra kursi, forma kontrolli të vazhdueshëm, është deri në 25 orë mësimore. Evidenca 4. 2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" ka rregulloren ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Sipas RVB dhe takimeve në muajin korrik rezulton se nuk ka patur në praktikën e tij procedurën e transferimit të studentëve, për arsyen se studentët mbarojnë ciklin e plotë të studimit brenda një viti akademik. Evidenca 4. 2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" përmban të gjithë informacionin lëndor dhe praktikën që lidhen me të si dhe të gjithë elementët formues të programit sipas kërkesave të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të Fakultetit. GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Evidenca 4. 2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA

<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimet GVJ konstatoi se fillim të çdo viti akademik programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim nga pedagogët e lëndës për përmbajtjen e temave në mënyrë që të mos ketë perseritje. Ndryshimet e kryera miratohen sipas përcaktimeve ligjore dhe pasqyrohen në dosjen e programit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është strukturuar me module 3, 4, 5, 6 dhe (praktika 10) ECTS. Në përfundim të studimeve studenti fiton 60 ECTS. Programi është në përputhje me ligjet në fuqi.</p> <p>Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 73 "Për programet e ciklit të parë të studimeve", pika 1, shprehet se "Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike". Neni 6 i këtij Ligji, "Për përkufizimet", pika 25, përkrahur se "Sistemi i studimeve me kohë të plotë" përfshin organizimin e programeve të studimit me ngarkesë akademike normale 60 kredite ECTS në një vit akademik".</p> <p>Rregullore e programit të studimit MPPSA</p>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", pika 2.1, "Për kreditet sipas ECTS-së" përcakton se:</p> <p>a) Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.</p> <p>b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.</p> <p>c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.</p> <p>ç) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.</p> <p>Në pikën 2.4/b të VKM/2018 përcaktohet se "Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë".</p> <p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive të fushës si dhe formimin e shprehive të veçanta brenda kuadrit të profesionit të punonjësit social.</p>



	Rregullore e programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.	Plani mësimor i programit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi" është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe European të studimeve, i organizuar në 2 semestra me kohëzgjatje 15 javore. Lëndët në varësi të specifikave aplikojnë seminare ku trajtohen detyra kursi individuale apo në grup, ese e projekte kursi për t'u ofruar studentëve përgatitjen teori e profesionale për fushën e studimit. Bazuar në objektivat dhe shpërndarjen e çdo lënde, bëhet e mundur arritja e rezultateve të të nxëniet dhe për rrjedhojë edhe aftësimi profesional Rregullore e programit të studimit MPPSA
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme ndërkombëtare dhe në bazë të Sistemit european të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri në 25 orë pune të studentit, duke përfshirë edhe kohën për studim individual. Kurrikula e programit është e organizuar në formë të tillë që studenti të ketë ngarkesë mësimore pothuajse të njëjtë përgjatë semestrave. <sup>2</sup> Ngarkesa vjetore e punës së një studenti është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore, GVJ evidenton se raporti teori praktikë favorizon më tepër praktikën në mënyrë që të arrihen objektivat e programit por edhe në funksion të punësimit.  FSHS/DPPS zotëron dokumentacionet përkatëse që tregojnë mbi praktikën e transferimit të studentëve në përputhje me përcaktimet në Nenin 24 "Kushtet për transferim ndërmjet programeve", pikat: 1, 2, 3, 4, 5, të Rregullores së Programit të MPPSA (2018). (Materiali 142/ 4.9 "Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit", e-ASCAL).  Gjithashtu, FSHS/DPPS dëshmon për praktika të mira të përfshirjes së studentëve në projekte mobiliteti, duke filluar nga viti 2016 deri në vitin 2022. (Materiali 124/ 3.20 "Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve", e-ASCAL).  Referenca -Programet mesimore te lendeve
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset) për ciklin e studimit, tregoi se ato janë hartuar në përputhje me elementet e modelit sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", Pika 2.8 "Programi lëndor (syllabus-et)".  Programet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit cdo vit akademik, fakt i konfirmuar nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjesi i saj.  GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se programet lëndore kanë të përditësuar literaturën e tyre sipas kërkesave ligjore në lidhje me 5 vitet e fundit.  Referenca: Programet e mesimore te lendeve
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi të ciklit të dytë se lëndët janë në përputhje me përfitimin e dijeve dhe aftësive të synuara.  Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.

<sup>2</sup> Evidenca 4 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA

	Referenca: 4.3 Programet e mesimore te lendeve						
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Duke marrë parasysh dhe sa janë përmendur në kriteret e mësipërme, GVJ gjykon se ky program ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale. Programi i studimit Master profesional "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi", fokusohet në përgatitjen për praktikën direkte të punës sociale në shërbimet psiko-sociale në kujdesin shëndetësor. Puna sociale në shëndetësi, është një fushë e specializuar e praktikës, brenda fushës së gjerë të profesionit të punës sociale. Vëmendja e punonjësve socialë e drejtuar në trajtimin e përcaktorëve socialë të shëndetit në mjedisin shëndetësor gjithnjë në zhvillim, plotëson një hendek kritik, i cili është jetik për përmirësimin e shëndetit dhe kujdesin shëndetësor.						
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme si edhe duke u bazuar te studimi i tregut te punes një pjesë e mirë e studenteve jane punesuar, cka bën të vlerohet se ka një përqindje të lartë përshtatje me pritshmeritë e tregut të punës. Për arritjen e objektivave formues dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit MP ASH, Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale, FSHS, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes "Listës se marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikën profesionale" se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, etj.						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Sipas Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", Neni 25 "Departamenti", pika 4, përcaktohet se "Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik".  Neni 59 i këtij Ligji, "Kategoritë e personelit akademik", Pika 6, specifikon se: <i>Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.</i>  Bazuar në tabelën mbi "Të dhënat e stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit GVJ konstaton se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Prof. Dr, Prof. Asoc, Dr, por edhe me titullin Msc por me ekspertizë dhe eksperiencë pune ne fushën përkate të mësimdhënies. GVJ konstaton se programi MP në "Punë Sociale e Avancuar" mbulohet me staf akademk efektiv dhe staf akademik me kontratë. Në bazë të të dhënave,



	<p>(tabela), modulet e ofruara janë mbuluar 8/11 lëndë me pedagogë të brendshëm dhe 3 module nga pedagogë të jashtëm. Sipas planit mësimor të programit të studimit MPPSA nga 1500 orë që ka ky program studimi 450 orë realizohen nga personeli akademik me kohë të pjesshme dhe pjesa tjetër realohet nga personeli akademik me kohë të plotë. Pra referuar VKM 418 ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë që mbulon programin e studimit është në masën 70 %.</p> <p>Në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit janë angazuar 6 PAE dhe 6 PAK. Të dhënat e mësipërme tregojnë se personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional “Punë Sociale e Avancuar” me drejtime arsim dhe shëndetësi, janë rekrutuar në bazë të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodit të Punës, Statutit, Rregullores së UT –së dhe Manualit të punësimit në UT.</p> <p>Baza kryesore ku mbështetet rekrutimi, janë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që DPPS publikon në fillim të vitit akademik, për pedagogët joefektivë dhe në rastet specifike, kur ka nevoja për rekrutime të stafit efektiv, sipas procedurës ligjore.</p> <p>Nga vizita dy ditore rezultoi se zyra e burimimeve njerëzore e FSHS-së, administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të personelit akademik efektiv me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ose të ftuar, duke përditësuar bazën e të dhënave.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit janë angazuar 6 PAE dhe 6 PAK. Të dhënat e mësipërme tregojnë se personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar CV-së personale të secilit nga personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit, vërehet se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e tyre, është në përputhje me drejtimin e programit të studimit MPPSA.</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p>Bazuar në tabelën mbi “<i>Të dhënat e stafit të Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit për vitin akademik 2018-2019</i>”, “<i>Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, e-ASCAL</i>), mësohet se aktualisht Departamenti dhe personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Prof. Dr 1, Prof. Asoc 1, Dr 6, dhe pjesa tjetër me Msc, por me ekspertizë dhe eksperiencë pune në fushën përkatë të mësimdhënies.</p>

	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><i>Referenca -4.16 CV Stafit Akademik.</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p>DPPS dëshmon se vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për praktikën profesionale. Në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit, shpërndan ngarkesën mësimore të praktikës te stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, i cili mbulon programin e studimit, si dhe cakton një supervisor të praktikës për studentët. Supervizori i praktikës është staf akademik me kohë të plotë pranë DPPS. Ai mbështet formalizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet FSHS/DPPS dhe Institucionit ku studentët do të realizojnë praktikën profesionale.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimit-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm 100% për programin në fjalë.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Punë Sociale e Avancuar” me drejtim në arsim dhe në shëndetësi ka një plan mësimor të pasur me lëndë të karakterit profesional por edhe kërkimor.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi II.6</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se janë të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Programit MPPSA të – 2021-2024” në pikën 7.4 Prioriteti strategjik 4: Zhvillimi i partneriteteve, përcakton disa objektiva avancimi i niveleve të bashkëpunimit me institucionet, agjencitë dhe organizatat që kanë nevoja parësore për profesionistë të punës sociale në drejtime specifike, siç janë arsimit dhe shëndetësi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet NJSBC institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve. Gjithsesi është akoma në fazë primare për të përcaktuar nëse reflektimi i propozimeve të studentëve në lidhje me programin e studimit është kryer për shkak të evidencave të pa mjaftueshme në lidhje me këtë.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

26

<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	DPPS kryen vazhdimisht studime për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron shumë të vlefshme në lidhje me vendimet strategjike në lidhje me programin por edhe me koordinimin administrativ të tij.  Paralelisht Zyra e ALUMNI dhe Këshillimit të Karrierës e ne FSHS ka ndërmarrë një nisëm për gjurmimin e studentëve të diplomuar në mënyrë që të krijohet një databazë me këta studentë. GVJ njeherë përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.		
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj. Institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Gjatë Vizitës që GVJ pati në Institucion me Përgjegjësin e Departamentit, evidentoi se anëtarët e stafit të departamentit aktivizohet në ekspertiza kombëtare e ndërkombëtare dhe kjo është një garanci më shumë për bashkëpunime që mbulojnë fushat e interesit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Zhvillimi i procesit mësimor realizohet sipas metodave klasike. Në këtë institucion të arsimit të lartë janë adaptuar sistemet e mësimdhënies dhe të vlerësimit të vazhduar me një ndarje prej: <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimi i ndërmjetëm</li> <li>• provimi përfundimtar</li> <li>• detyrat e kursit/prezantim/punë në grup</li> <li>• pjesmarrja aktive në seminar</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se UT, FSHS, DPPS nxit zhvillimin e përdorimit të metodave interaktive dhe inovative të mësimdhënies. Stafit akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit</p>

	<p>me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja.</p> <p>Gjithashtu, për të siguruar vijueshmërinë e mësimit në kushtet e pandemisë COVID-19, UT ka hartuar një udhëzues të posaçëm për realizimin e mësimin online përmes platformës elektronike Microsoft Teams. Dokumenti përmban udhëzime metodologjike mbi mënyrën se si të kryhet mësimi në distancë, si të përditësohen programet e lëndëve, si të vlerësohen studentët, etj. (166/1.15 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë, e-ASCAL).</p> <p>Kjo platformë vazhdon të përdoret gjerësisht nga stafi akademik për nevojat e procesit mësimor. Aktualisht ajo shërben si bazë dokumentacioni e vënë në dispozicion të studentëve për të aksesuar shpejt dhe në kohë reale materialet mësimore, literaturën online, apo ciklet e leksioneve, artikujt e ndryshëm shkencorë, detyrat e kursit, për të shkëmbyer njoftime të ndryshme, etj.</p> <p><i>Pavarësisht zotërimit të rregulloreve dhe udhëzuesve të ndryshëm për aspekte dhe situata të caktuara të mësimdhënies, FSHS/DPPS i ka të gjitha kapacitetet pedagogjike për të hartuar në të ardhmen një udhëzues në nivel institucional dedikuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve që ofron.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Nuk rezulton që të perdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogjesh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike (çdo vit akademik) nga departamenti dhe fakulteti përkatës nëpërmjet analizës së punës mesimore shkencore.</p> <p>FSHS/DPPS, si pjesë e UT ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT.</p> <p>UT ka hartuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga takimet me studentet rezulton se përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve kryhet nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë, çdo fund semestri.</p> <p>Në Rregulloren e NJSC (2020), Neni 6 “Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi”, pika 4 shprehet se “Monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi bëhet në mënyrë periodike dhe për raste të vecanta” (fq. 3). Në Nenin 7 të kësaj Rregullore “Për Komitetin e sigurimit të cilësisë së FSHS”, pika 2, shprehimisht thuhet se “KSC-ja ka pesë anëtarë, një përfaqësues të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


28  


	dekanatit, dy përfaqësues të të personelit akademik, një personel ndihmësakademik dhe një përfaqësues të studentëve” (fq. 4). (Materiali 1.6 Rregullore e NJSC (2020) e-ASCAL).		
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional, si struktura përgjegjëse brenda FSHS-së, për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, publikon në mënyrë periodike raportin e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë të mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, së bashku me rekomandimet përkatëse. NJSC e FSHS është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FSHS. Kjo njësi ka si <i>mission</i> të planifikojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësi i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të FSHS (2020), Neni 13 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë” lidhur me sigurimin e cilësisë, pika g, përshkruan se “Drejtuesi i departamentit përdor informacionin e vlerësimit për qëllime të përmirësimit të veprimtarisë së njësisë që drejton, të përmirësimit të programeve të studimit dhe të promovimit të personelit akademik”.  Në Nenin 23 të kësaj Rregullore, “Për përdorimin e të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit”, specifikohet se “Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në këtë rregullore, përdoren për: a) përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; b) akreditim; c) përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; d) planifikimin vjetor dhe strategjik të FSHS; e) përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmëskademik dhe administrativ”.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
		X	

### Standardi III.2


**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome. Format e kontrollit të dijeve: aktivizimi gjatë orëve mësimore, testimet e ndërmjetme, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e detyrave të praktikës profesionale, provimi final, mbrojtja e temës së diplomës. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët dëshmohej se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet, seminarët dhe praktika profesionale, të cilat organizohen në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies, si: lojë me role, brain storming, diskutim në grup, raste studimore, vëzhgime në situata praktike, refleksione, nxitje e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore,



	<p>prezantime në PowerPoint, etj., duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën (informacion nga takimet në kuadër të vizitës në institucion, korrik 2022).</p> <p>Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHS/DPPS, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe vecorive së çdo lënde dhe të bazës materiale të nevojshme.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve (<i>Referenca – 4.3 Programet mesimore të lëndëve</i>). Format e mësimi teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ pati mundësi të bashkëbisedojë edhe me një studente me AK, e cila shpjegoi se institucioni mbështet përpjekjet e saj për të përfutur arsimim të barabartë, si dhe pedagogët lehtësojnë procesin e të nxënës duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies në përgjigje të studentëve me nevojave të veçanta.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive. UT, FSHS synon vazhdimisht përmirësimin e kushteve të punës për personelin akademik dhe administrativ, si edhe përmirësimin e infrastrukturës për të mundësuar kushte të mira pune dhe realizimin e objektivave të institucionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Referenca 3.18 Raporti për veprimtarinë e programit të studimit për vitin 2020-2021</p> <p>Sipas këtij raporti mësohet se stafi akademik që mbulon programin e studimit të marrë në vlerësim, ka marrë trajnime të mbështetura institucionalisht për të përmirësuar kompetencat e tij në fushën e teknologjisë informatike me synim realizimin e mësimdhënies online nëpërmjet platformës elektronike TEAMS, të cilën shumica e tyre vijnë ta shfrytëzojnë për komunikim me studentët, për detyrat me shkrim, shpërndarjen e literaturës online, konsultime, njoftime, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit.</p> <p>Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në projekte dhe eksperiza të tjera brenda vendit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p> <p>Nga krahasimi i të dhënave të CV-së së PA dhe syllabuseve të lëndëve që ata zhvillojnë, vërehet një përputhje midis fushës akademike dhe kërkimore të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që ai zhvillon.</p> <p>FSHS/DPPD respekton procedura dhe kriteret (të përgjithëshme, të veçanta dhe preferenciale) të parashikuara në dokumentin “Manualin për</p>

	<p><i>punësimin e personelit në UT</i>” (2022), për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për t’i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programit të studimit MPPSA.</p> <p>Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit MPPSA.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Kryesisht njësia bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Çdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik. Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor.</p> <p>Sipas dokumentit “<i>Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së</i> (2021), “<i>Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...</i>” (fq.9). Në pikën 4 të këtij dokumenti “<i>Për parimet e vlerësimit</i>” specifikohet se “<i>Përgjithësisht vlerësimi bëhet nga disa aktorë, që janë drejtuesi i njësisë bazë, vetë personi (anëtar i personelit akademik), studentët dhe grupi i vlerësimit të njësisë bazë...</i>” (fq. 8). Në vijim të dokumentit, në Tabelën nr. 1 janë pasqyruar subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik, duke përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga studentët (fq. 10). Në Aneksin nr. 1, është paraqitur “<i>Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues</i>” që materializon procesin e vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik. “Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë” (fq.19)</p> <p>Referenca 1.13 “<i>Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së</i> (2021)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimi që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfituar nga ky diskutim.</p> <p>Refruar programeve lëndore të përgatitura nga titullarët e lëndëve përkatëse, vërehet se theksi është vënë në përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimit, duke synuar që orët e mësimi të jenë tërheqëse dhe gjithëpërfshirëse. Ndeshet një larmishmëri e formave të përdorura në mësimdhënie, si: lojë me role, studim rasti, fokus-grupe, brainstorming, diskutim mbi detyrat studimore, refleksione dhe analiza, etj., që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimi Referenca 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit MPPSA, e-ASCAL).</p> <p>Studentët e programit kanë adresuar komente pozitive për pedagogët e tyre, gjatë takimit/vizitës në institucion, lidhur me metodat interaktive të përdorura gjatë leksioneve, seminareve dhe veprimtarive të tjera mësimore.</p>



	Nga vizita ne institucion mesuam se personeli akademik perpiqet qe te angazhoje studentet me diskutime brenda fushes se lendes apo realizojne konkurse dhe vizita studimore, per ta bere me terheqese oren e mesimit.		
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mesimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mesimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit, i nivelit master profesional, i është larguar formës klasike së mesimdhënies. Programi ka karakter sa teorik po aq edhe praktik dhe profesional. Studentët nxiten shumë për punë të pavarur. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve njerëzore dhe komunitare. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se procesi i mesimdhënies dhe të nxënit në FSHS realizohet në një klimë pozitive. Pedagogët respektojnë lirinë e mendimit të studentëve, duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë dhe të menduarit kritik e krijues të tyre.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b> <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mesimdhënies, mesimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Nga vizita që GVJ pati në Institucion, evidentoi se godina e FSHS që përdorej edhe për këtë plan studimi, mundëson që procesi mësimor e shkencor për të gjitha programet e studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mesimit semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambjentet, internet, e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, etj.</p> <p>Sipas dokumentit “Të dhëna për infrastrukturën FSHS”, Fakulteti i Shkencave Sociale zhvillon aktivitetin e tij në një godinë me katër kate. Godina ka në dispozicion një sipërfaqje prej 7977 m<sup>2</sup> në total, ku 7154 m<sup>2</sup> shrytëzohen për mjedise për zhvillimin e mesimit të programve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, dhe 823 m<sup>2</sup> janë zyra për stafin. Gjenden 6 salla leksionesh, 16 klasa për seminarët, 2 salla për aktivitete promovuese, 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale, 1 sallë interneti, 2 salla për bibliotekën, 1 mjedis për fotokopjime e librari, 1 zyrë informacioni për studentët, 4 koridore, 4 mjedise mbështetëse, 1 mjedis për aktivitete të qeverisë studentore, 14 nyje hidrosnitare për studentët.</p> <p>Këto mjedise përdoren nga 2690 studentë. Hapësira për një student rezulton afërsisht 2.7 m<sup>2</sup>/për 1 student.</p> <p>Në dokumentin “Të dhëna për infrastrukturën FSHS” shënohet gjithashtu, se në këtë fakultet mësimi zhvillohet me dy turne (Materiali 53/2.33 Të dhëna për infrastrukturën FSHS, e-ASCAL).</p> <p>Fakti që në godinën e FSHS, mësimi zhvillohet me dy turne, tregon se numri i sallave për leksione, seminare dhe veprimtari të tjera mësimore nuk është plotësisht i mjaftueshëm.</p> <p>Nga kqyrja e mjediseve mësimore, u vërejt se sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor, janë të pajisura me</p>



	videoprojektor dhe internet. Mjediset janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i kontraktuar për këtë shërbim.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, Sallat e leksioneve janë të pajisur me projektorë. Godina e ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> / student.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Universiteti i Tiranës, FSHS ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor. Universiteti i Tiranës ofron për personelin akademik dhe studentët platformën online “Microsoft Teams” (Dokumenti 1.15 Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë). Kjo platformë ka nisur të përdoret fillimisht në përgjigje të kushteve të izolimit nga pandemia Covid19, por gradualisht kjo infrastrukturë është konsoliduar dhe vijon të përdoret nga pedagogët dhe studentët për nevoja mësimore, si: leksione, literaturë online, materiale shtesë audio-vizive, njoftime, konsultime, etj.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Nga shqyrtimi i programeve lëndore të programit të studimit MPPSA, rezultojnë se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve, në gjuhën shqipe dhe angleze (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet teksteve mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme. FSHS ka dy salla bibliotekë me një sipërfaqe 189.5 m <sup>2</sup> . Kapaciteti i bibliotekës plotëson nevojat për lexim/studim të studentëve dhe personelit akademik. Biblioteka është e pajisur me tetë kompjutera dhe internet. Në fondin e bibliotekës janë rreth 7343 tituj fizik gjithsej, dhe 3906 libra fizik gjithsej, si dhe 154 periodike revista/buletine shkencore në shqipe dhe në gjuhë të huaj. Fondi i librave gjendet në format hardcopy dhe elektronik dhe duket se plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Tituj në gjuhë shqipe janë gjithsej 2573, ndërsa në gjuhë të huaj, kryesisht, anglisht, fengjisht, italisht, janë gjithsej 1333 tituj. (Materiali 2.29 Informacion për bibliotekën, e-ASCAL).
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej gjerësisht nga studentët me të cilët GJV zhvilloi takimin. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale ka në dispozicion një sërë platformash e bibliotekash online që u japin mundësi studentëve dhe stafit akademik ta shfrytëzojnë në kohë reale, duke mundësuar akses në libra, revista e artikuj shkencore të viteve më të fundit. Në këtë kuadër mund të përmenden abonimet me akses të financuar nga FSHS, të tilla: EuroPS-Services; Publications UNRISD; Springer; Journals Sage Pub; Wiley. Sipas bisedës me punonjësen e bibliotekës, procedura e aksesimit të këtyre

	<p>adresave elektronike kërkon që përdoruesi (studenti/pedagogu) të pajiset me një username dhe një fjalëkalim.</p> <p>Gjithashtu, për pedagogët dhe studentët është mundësuar akses i lirë në: Libraria digjitale JSTOR; UNRISD website publications; Katalogu online në platformën Cobiss.net Albania (akronim UTFSHS).</p> <p>Për pedagogët është mundësuar akses i në revistat (online) si: History and Theory; International Journal of Human Rights; Social and legal Studies; European Journal on Criminal Policy and Research crime, laë and social change</p> <p>Referuar RVB- Akses i në librarinë online në U-Library: <a href="http://U-Library.rash.al">U-Library (rash.al)</a>. Gjithashtu ka akses dhe në bibliotekat online EBSCO dhe SAGE.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>FSHS ka salla konferencash dhe ambient studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre.</p> <p>Për realizimin e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike të studentëve, institucioni ka vënë në dispozicion sallën e kompjuterave, mjediset fizike dhe virtuale të bibliotekës, dhe salla të tjera mësimore të cilat janë komode dhe të pajisura me internet (Informacion i siguruar gjatë vizitës në institucion, korrik 2022).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platformën online "Microsoft Teams". Kjo platformë ka filluar të përdoret për mësimdhënien në distancë gjatë situatës së pandemisë Covid-19. Stafit ka marrë trajnime në këtë fushë dhe vijon ta përdorë platformën online "Microsoft Teams", duke inkurajuar studentet që të eksplorojnë hapësirën e-learning, të shkarkojnë materialet mësimore të hedhura nga pedagogët, si: leksione, materiale shtesë audio-vizive, botime online, etj., si dhe të ruajnë komunikimin e vazhdueshëm me stafin akademik për njoftime, informime dhe konsultime.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nrm platformës Teams.</p> <p>Aktualisht kjo platformë është funksionale dhe e hapur si për pedagogët dhe studentët, një pjesë e tyre e përdorin për të shkëmbyer mesazhe, ngarkuar materiale, si leksione dhe detyra kurse. Sistemi komunikimi i brendshëm për akses të personelit akademik dhe studentëve në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar, realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të UT-së, E-student, <a href="mailto:emer.mbiemer@unitir.edu.al">emer.mbiemer@unitir.edu.al</a>. Ky sistem kërkon që fillimisht përdoruesit të regjistrohen dhe në vijim mund të aksesojnë sistemin në çdo kohë dhe vend, duke shkëmbyer informacion në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme, etj.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen dhe përpilimin e temave të diplomave në përputhje me fushat e kërkimit që mbulon. Udhëheqësi i punimit të diplomës, përgatit programin e punës së studentit duke i vendosur afatet e përafërta për realizimin e tij.</p> <p>Drejtimesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti. Për çdo fushë diplomimi, departamenti brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, u bën të njohur studentëve të vitit të fundit tezat e diplomave.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, studentët dhe stafi akademik pohuan se personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), si dhe asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> <p>Evidenca 3.3.6. Rregullore e programit të studimit MPPSA</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit

X

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kurrikulave, në Institucion funksionojnë në funksion të procesit mësimor-kërkimor disa struktura:

- a) struktura e programeve mësimore dhe e sigurimit të cilësisë;
- b) struktura e marrëdhënieve me jashtë dhe studentët;
- c) struktura e kërkimit shkencor dhe IT-së;
- ç) struktura juridike dhe e marrëdhënieve me publikun;
- d) struktura e burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit.

Këto struktura ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit.

UT ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Ekipin e Vlerësimit të Brendshëm të UT, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

UT ka hartuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT” (2021), ku përcaktohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të personelit akademik të UT të të gjitha kategorive, duke filluar nga personeli me i ri e deri tek profesorët (fq. 6). Vlerësimi i performancës individuale të personelit akademik krijon mundësinë që të rritet motivimi dhe shkalla e angazhimit të tij në realizimin e procesit mësimor, si dhe kërkimit shkencor me standarde dhe cilësi të lartë. Niveli i arritjes që rezulton nga vlerësimi synon të reflektohet në përfitime, korrigjime ose rekomandime për të ardhmen ndaj anëtarëve të personelit akademik (fq.7).

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.


Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.

Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët.

FSHS/DPPS, si pjesë e UT ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

FSHS ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si: Komisioni/Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC) dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel fakulteti, e cila e bazon punën e saj në Rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UT, Rregulloren e NJSC (2020), dhe udhëzimet përkatëse të ASCAL.

<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në FSHS, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPPS mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes krijimit të hapësirave për organizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj, trajnimeve, simpoziumeve e konferencave, projekteve të mobilitetit, projekteve ndërkombëtare që kanë në fokus eksperimentimin me metoda të reja në AL</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik deklaroi se institucioni krijon mundësi që stafi akademik dhe ndihmësakademik të marrë pjesë pa pagesë në konferencat që organizon UT dhe FSHS. Gjithashtu, ata u shprehën se institucioni financon pedagogët një herë në dy vjet për një pjesëmarrje në një konferencë jashtë vendit, duke përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe fee të konferencës.</p> <p>Në FSHS/DPPS, personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i FSHS dhe Departamentit të Punes dhe Politikave Sociale, kualifikohen brenda dhe jashtë institucionit, si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimi të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në FSHS/DPPS trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p>Në dokumentin “Politika të Zhvillimit Profesional të Personelit Akademik të FSHS” (2020), janë pasqyruar llojet e veprimtarive që përmban programi i zhvillimit profesional në FSHS (fq. 8),</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Gjate vizites dhe takimit me stafin u konfirmua se ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimin e programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p> <p>Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik dëshmon se është përgjegjës për zbatimin e programit të studimeve MPPSA dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>



	Referuar CV të stafit që mbulon programin e studimit MPPSA, konstatohet një përpjekje dhe angazhim i vazhdueshëm i personelit akademik dhe ndihmësakademik, për të marrë pjesë në konferenca kombëtare ose ndërkombëtare, programe trajnimi/kualifikimi, programe shkëmbimi, projekte kërkimi, etj.						
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit. Në dokumentin "Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), Aneksi nr. 1, është paraqitur "Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues" që materializon procesin e vetëraportimit nga ana e personelit akademik. Objektivat e performancës përfshijnë edhe elemente të procesit mësimor. Mbi bazën e objektivave të parashikuara, personeli angazhohet për realizimin e tyre në kohë dhe me cilësi. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë" (fq.19) (Dokumenti 14/1.13 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së (2021).						
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Universiteti i Tiranës, FSHS rezultojnë të ketë marrëveshje dhe parteritete me Institucione të Arsimit të Lartë në vend dhe jashtë duke zhvilluar herë pas here edhe leksione të hapura. Ky angazhim ka ndihmuar në rrjetizimin e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere. Kjo praktikë pune synon nxitjen e kërkesave personale të stafit akademik dhe ndihmësakademik në drejtim të planifikimit/parashikimit të rritjes profesionale dhe të vetëraportimit të rezultateve të arritura në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.  Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë të të nxëniet përmes një ndërveprimi të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tregut të punës.						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pafullësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pafullësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pafullësisht					
		X					

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve.  Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare.  Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit që përbën një dokument rregullator të posaçëm i cili përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes së punimit; udhëzime për strukturën dhe metodologjinë e kërkimit; specifikimet teknike për punimin, udhëzime për monitorimin e

	<p>përgatitjes së punimit; udhëzime për prezantimin dhe vlerësimin e punimit të diplomës' përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin ekësaj veprimtarie; dhe rregullat etikës së kërkimit.</p> <p>Rregullore e praktikës profesionale (2018) është një dokument rregullator që përfshin kriteret, udhëzimet, procedurat e sistemin e vlerësimit të rezultateve të praktikës profesionale për studentët e programit të studimit.</p> <p>Këto dokumente janë publike dhe të njohura nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe ndihmësakademik.</p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatoam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit.</p> <p>Gjithashtu i njëj studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës, studentët informohen rregullisht, në fillim të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin MPPSA, në kategorinë "Forma e kontrollit të dijeve", është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve.</p> <p>Në fillim të çdo lënde, titullari i lëndës informon studentët rreth përmbajtjes së programit lëndor dhe mënyrës së testimit/vlerësimit. Dokumenti 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit MPPSA</p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas rregullores së UT, kontrolli i dijeve bëhet: me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyrat, format dhe elementët e kontrollit të dijeve përcaktohen në rregulloret e brendshme të fakultetit. Ku janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studentit gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim; me gojë ose i kombinuar duke u specifikuar më parë në programin e lëndës; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</p> <p>Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Evidenca 1.1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2016</p> <p>Evidenca 2.2.4. Rregullore e FSHS</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht					
		X					

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit. Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin MPPSA, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijeve”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohen gjatë gjithë vitit, si: kontrolli i vazhdueshëm (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi), kontrolli i ndërmjetëm (testimi në mes të semestrit) dhe provimi përfundimtar (me shkrim/gojë ose i kombinuar). (4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, e-ASCAL).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimiit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga vizita në Institucion, GVJ nuk evidentoi përdorim të ndonjë sistemi elektronik për testimin apo edhe vlerësimin. Pikët e akumuluar në provimet me shkrim dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p>Testimi përmes sistemit elektronik “Microsoft Teams” është aplikuar vetëm në kushtet e pandemisë globale. Staf akademik dhe studentët pohojnë se aktualisht sistemi përdoret për të marrë përgjigjet e vlerësimeve në një lëndë të caktuar, por jo për testim.</p> <p>Kjo mënyrë e komunikimit të vlerësimeve ndihmon në eliminimin e abuzimit me vlerësimet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisionet e provimeve përbëhen së paku nga 2 anëtarë ku njëri prej tyre duhet të jetë i brendshëm që zakonisht është pedagogu apo lektori i lëndës dhe tjetri asistenti ose një pedagog që ka të njëjtin profil ose të përafert.</p> <p>Komisioni i vlerësimiit si rregull përbëhet nga dy pedagogë, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë me shumë se dy pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimiit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimiit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p>Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Testimi i vlerësimiit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. Në sallën e provimit nuk lejohen të hyjnë persona të tjerë, përveç anëtarëve të komisionit të provimit /pedagogëve të lëndës, monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatën e çdo studenti. Pasi korrigjohen testet e provimit, dorëzohen në Sekretarinë Mësimore e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerr rezultatin për çdo student. Komisioni i ngritur dhe i miratuar nga përgjegjësi i departamentit</p>

	monitoron procesin e çsekretimit nga SM. Ky proces asnjëherë nuk kryhet në mënyrë individuale, pa praninë e të dy pedagogëve të lëndëve”.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit. Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe menyrën e referimit të saj. Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe ndihmësakademik, GVJ mësoi se “Plagjiatura apo kopjimi në provime mund të shmanget në FSHS sepse stafi respekton dhe zbaton me korrektesë rregullat lidhur me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kushtet e sekretimit të tezës së provimit nga sekretaria mësimore,</li> <li>- monitorimin e procesit të provimit nga komisioni i përbërë nga dy pedagogë të lëndës,</li> <li>- moslejimin e përdorimit të së njëjtës tezë provimi me grupe që zhvillojnë provim në orare të ndryshme, mospërsëritjen e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë edhe sezonin e riprovimit), etj.</li> </ul> Përsa i përket shmangjes së plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik shprehet se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni”.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	FSHS bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen mbi meritën dhe të jepen në kohën e përcaktuar. <p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e provimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 15 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, e cila njofton studentët individualisht për rezultatin.</p> Zbatimi i një sistemi të detajuar pikëzimi tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të bazuara në meritë.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore.



	<p>E drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin garantohet nëpërmjet zbatimit të Rregullores së FSHS (2018), Nenit 36 "Sistemi i vlerësimit", pikës 3, ku përcaktohet se "Rezultatet e provimit u bëhen të qarta studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Rezultatet komunikohen individualisht".</p> <p>Gjithashtu, e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit garantohet nëpërmjet zbatimit të Nenit 40 të Rregullores së FSHS (2018) "Përmirësimi i notës", që përcakton se "Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës nëpërmjet rihyrjes në provim në çdo vit akademik, deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Për përmirësimin e notës studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e riprovimeve duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Studenti i vitit të fundit ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshi këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse".</p> <p>Referenca 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL).</p>						
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Po sipas rregullores së FSHS-së, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim te përgjegjësi i departamentit ose tek sekretaria e departamentit, brenda 48 orëve nga marrja e dijeni e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit, pasi bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.</p> <p>Dekani, brenda 48 orësh nga marrja e dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Në rast se studenti pretendon se ka konflikt me pedagogun e lëndës, mund t'i kërkojë drejtuesit të njësisë bazë për të ndryshuar komisionin.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi realizohet nga një staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj akademik, si dhe me përvojë në fushën e kërkimit dhe praktikave (Materiali 4.16.CV e personelit akademik te brendshëm për programin e studimit, e-ASCAL).</p> <p>Programi siguron lidhjen e teorisë me praktikën duke ballafaquar dhe familjarizuar studentët me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. Programi zhvillohet në mjedise me një infrastrukture të përshtatshme, të pajisur me teknologji që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore, të mbuluar me internet dhe wirlës, me bibliotekë të pasur me libra fizik dhe burime online.</p> <p>Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe mënyra se si ky program zhvillohet/ofrohet nga FSHS/DPPS, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të objektivave të caktuara për formimin e studentëve, të cilat</p>

	<p>përbëhen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale, që studentët duhet të fitojnë, në përfundim të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, sipas ligjit. Nuk përfshihen lëndë në gjuhë të huaj.</p> <p>Institucioni dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit të studentëve për të përdorur sistemin "Microsoft Teams" për qëllime mësimore dhe platformat online për të shfrytëzuar literaturën në bibliotekat online.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>DPPS, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundëshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të FSHS.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik në institucion, GVJ mësoi se pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p> <p>Gjithashtu, në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB edhe në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët.</p> <p>FSHS/DPPS disponon disa të dhëna të detajuara për tematikat e trajtuara me studentët në kuadër të formimit profesional të studentëve dhe përditësimit të tyre me zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, të cilat stafi akademik dhe të lektorë të ftuar, organizojnë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p>Përsa i përket aspektit metodologjik të mësimdhënies, studentët dhe pedagogët deklaruan gjatë vizitës në institucion se leksionet, seminarat dhe veprimtaritë e tjera mësimore, realizohen mbi bazë kompetencash, duke ju dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë dhe shprehitë e nevojshme profesionale në situata praktike. Stafi akademik dhe studentët treguan se në shumicën e lëndëve mësimore, veçanërisht të lëndëve karakterizuese, mësimdhënia realizohet duke përdorur metoda interaktive, si: lojë me role, analizë dhe diskutim mbi raste klinike/raste studimore, etj.</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programet e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut (<i>Referenca Programet mesimore te lendeve</i>).</p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatojmë se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se personeli akademik kishte si pike të fortë krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, jo vetëm përmes inkurajimit të diskutimit të lirë në auditor dhe veprimtari zhvilluese jashtë programit të studimit, por edhe nëpërmjet mbështetjes me literature dhe udhëzime për realizimin e detyrave me natyrë studimore të cilat punohen individualisht ose në grup.</p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. FSHS inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore apo botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët e tyre.</p> <p>Por nga takimet e zhvilluara dhe nga RVB deri tani, financimi në nivel institucioni ka qenë modest.</p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se FSHS është pjesë e projektit Erasmus+ KA107 që mundëson mobilitetin e stafit dhe studentëve të UT-së. Thirrjet për aplikim të stafit dhe studentëve në programe shkëmbirni publikohen herë pas here në faqen zyrtare të UT <a href="https://unitir.edu.al/">https://unitir.edu.al/</a> dhe FSHS <a href="https://fshs-ut.edu.al/">https://fshs-ut.edu.al/</a>.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>FSHS ka hartuar procedura të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Referuar nenit 78 të rregullores së FSHS, praktikat profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e punonjësit mësimor të caktuar nga departamenti duke respektuar rregullat e atij institucioni. Praktikrat kryhen në grupe mësimore sipas përcaktimeve për madhësinë e grupit që lejojnë udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Evidenca 2.4. Rregullore e FSHS</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe</p>	<p>Ne vijim sipas nenit 73 dhe 75 të rregullores së FSHS gjatë praktikës profesionale, personeli mësimor që e drejton është gjithnjë i pranishëm,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

43

stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitim sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën e vet dhe të institucionit ku kryhet praktika. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje publike apo private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Evidenca 2.4. Rregullore e FSHS						
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Po sipas nenit 74 të rregullores së FSHS në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet nga personeli mësimor që drejton praktikën, pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë. <i>Në fund të praktikës përfundimtare</i> , punonjësi i ri në prag të kualifikimit duhet të demonstrojë njohuri, aftësi dhe vlera ndaj punës me një shumëllojshmëri grupesh dhe aftësinë për të marrë një seri detyrash, kapacitet për të punuar me situatë komplekse; ata duhet të jenë të aftë të punojnë në mënyrë autonome, por duke e ditur që vendimi final i mbetet supervizorit. Evidenca 2.4. Rregullore e FSHS						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi III.9</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	FSHS ka hartuar procedura të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.  Nga verifikimi i GVJ diplomimi studentëve në këtë program bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome. Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në <i>Rregulloren e FSHS</i> .  <i>Sugjerohet që punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të FSHS.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	FSHS/DPPS, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.  FSHS ka publikuar Rregulloren e Diplomimit në FSHE që përshkruan procedurat e provimit të final të diplomit.  Sipas RVB Sekretaria mësimore, pedagogu udhëheqës i temës së diplomës, si dhe pedagogët asistojnë studentët duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme, në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës, në respektim të Rregullores së programit të studimit MPPSA.  Punimi i diplomës është hulumtim a studim, që realizohet në mënyrë individuale dhe të pavarur për një çështje a problem nga fusha e programit të studimit e cila paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të programit.  <i>Nuk rezultojnë te këto një procedure te vecante per mbrojtjen e temes se diplomes.</i>

<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbyllet vetëm me mbrojtjen e mikrotezës. Mbrojtja e mikrotezës bëhet para një komisioni prej 3 anëtarësh të stafit akademik që japin mësim në këtë program studimi, juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Sipas vizitës në institucionin staf akademik ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në lidhje me punimin e diplomës. Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat si dhe udhëzimet për punimin e diplomës. Personeli akademik gjithashtu asiston studentët brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar seanca metodologjike, konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në bibliotekë, mjedis të mbuluar me WiFi etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>FSHS/DPPS asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore. Përsa i përket përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës, personeli akademik i cili udhëheq studentin një dhe zbaton përcaktimet e “Rregullores së Diplomimit në FSHS”, Neni 7 “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës”</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga verifikimet dhe vizita në institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studentin, duke dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Pedagogut udhëheqës i kërkohet: - të japë mbështetjen e duhur profesionale dhe konsulencën e nevojshme që të mundësojë kandidatin të arrijë standarde të larta të punimit; - të mbajë takime të rregullta me studentin (një në muaj) për të dhënë këshilla dhe për të qënë në dijeni të ecurisë së punimit; të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin, për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para komisionit të mbrojtjes, të bëjë kritikën e duhura për punën e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës. FSHS si pjesë e UT, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat krijojnë mundësi jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe për realizimin e punimeve studimore nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas “Rregullores së Diplomimit në FSHS”, Neni 6 “Procedura të provimit të diplomës” që shprehet se “Për provimin e diplomës ngrihet një komision... Vlerësimi i studentit bazohet në pikët totale të fituara prej tij për të gjitha pyetjet e paketës së provimit. Pikët konvertohen në note. Notat pasqyrohen në procesverbalin e provimit dhe konfirmohen me firmën e secilit anëtar të Komisionit të provimit. Kryetari i Komisionit të provimit i përcjellë Sekretarëve mësimorë procesverbalin. Studentët njoftohen individualisht për vlerësimin. Në Nenin 7 të Rregullores së Diplomimit në FSHS, për “Për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës”, pika 10 shprehet se “Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe</p>

	<p><i>kryhet para një komisioni të miratuara nga drejtuesi i departamentit dhe zëvendësdekani që mbulon programin. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë. Komisioni funksionon kur janë prezentë 2/3 e anëtarëve të tij. Pranzimi zgjat 10-15 minuta. Komisioni i bën pyetje studentit dhe më pas vlerëson cilësinë e punimit. Vlerësimet kryhen me pike sipas skedës së vlerësimit që përfshihet në Paketën e punimit të diplomës. Pikët konvertohen në note. Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimi i komunikohet çdo studentit diplomant individualisht". (Dokumenti 181/ 2.11 Rregullore e diplomimit, e-ASCAL).</i></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në Programin Master Profesional, studenti pajiset me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës.</p> <p>Kjo procedure është e përcaktuar në Rregulloren e FSHS (2018), Neni 42 "Diploma", që shprehet se "FSHS pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar... Diplomat për ciklin e dytë shoqërohen me Suplementin e Diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryesr dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës është përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përmbajtja dhe forma e diplomës së Suplementit të Diplomës është përcaktuar në Statutin e UT, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit... Diploma plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nshkruhet nga Dekani dhe Rektori i UT...Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UT".</p> <p>Evidenca 2.4 Rregullore e FSHS, e-ASCAL.</p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë MPPSA, studentit i vihet në dispozicion kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi se "Kopja zyrtare e programit të studimit MPPSA përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>UT/FSHS ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p> <p>Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FSHS disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Udhëzuesin mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë të të dhënave personale.</p> <p>Evidenca 1.9 Privatësia UT, e-ASCAL</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Universiteti i Tiranës(më tej UT) ka në strukturën e vet njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, mbështetur në statutin e UT: neni 44, dhe një përfaqësues i saj është atashuar në Fakultetin e Shkencave Sociale(më tej FSHS), me detyrë të mbledhë, të ruajë dhe përditësojë të dhënat për personelin e angazhuar në programin Master Profesional Punë Sociale e avancuar, me profile Punë Sociale në Arsim dhe Punë sociale në Shëndetsi(më tej MPPS-PSA/PSSH).</p> <p>Nga shqyrtimi i raportit të vlerësimit të brendshëm(më tej RVB) dhe vizita në institucion vlerësojmë se institucioni ka ruajtur të dhënat për personelin akademik, efektiv dhe të ftuar, sipas organigramës së UT dhe strukturën analitike të FSHS, në rang njësie bazë me personelin përkatës. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale(më tej DPPS) ka ndërtuar prej vitesh një praktikë pune të mirëorganizuar për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e angazhimit të çdo anëtari në secilin semestër dhe vit akademik të përfshirë në programin e studimit dhe personat përgjegjës për funksionimin e duhur të programit të studimit sipas profileve përkatëse.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar:</i> 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT dhe neni 44, 1.3. Rregullore e UT; 1.7 Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.8 Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 2.19. Informacion për politikën e burimet njerëzore dhe vlerësimin e personelit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatojmë se DPPS në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e thirrjes, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendime në bazë të kriterëve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme, si Statuti dhe rregulloret e UT dhe FSHS. Shih dokumentacioni e dosjes në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm(më tej GVJ).</p>

	<p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT dhe neni 44, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT.</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatohet se DPPS në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për rekrutimin e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e thirrjes në faqen e Agjencia e Prokurimeve Publike (më tej APP-së) duke paraqitur dhe afatet kohore të aplikimit, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendime në bazë të kritereve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme, Statuti dhe rregullore e UT/FSHS dhe i bën publike.</p> <p>Për vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për vendet e lira të punës për staf akademik efektiv apo me kontratë, Dekani krijon komisionin ad hoc me përbërje 5 anëtarë sipas kësaj ndarjeje: 3 anëtarë nga departamenti që ka aplikuar, 1 anëtar përfaqësues i Dekanit, 1 anëtar përfaqësues i Rektoratit/punëdhënësit. Komisioni mbi bazën e manualit të punësimit administron procesin, përmes hartimit të kritereve objektive të vlerësimit të dosjes dhe intervistës me gojë që ndërtojnë një sistem vlerësimi me pikë për çdo konkurrent/e.</p> <p>Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës ndjek të gjitha procedurat në lidhje me rekrutimet e reja, si koordinimin e punës me Njësinë Bazë, shpalljen e vendit të punës në APP dhe në faqen e UT-së, hartimin e ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritjen e komisionit ad hoc, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, dhënien e informacionit përfundimtar, shpalljen e vendimit dhe lidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, Rektori i UT-së.</p> <p>Shih dokumentacioni e dosjes në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe praktikave të rekrutimit (më tej GVJ).</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT dhe neni 44, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatohet se DPPS në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për rekrutimin e personelit bazuar në kritere të përgjithshme dhe specifike që garantojnë rekrutimin e personelit akademik në përputhje me nevojat e programit bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT/FSHS. DPPS kujdeset që stafi akademik të përditësojë CV akademike rregullisht, Marrëveshjen vjetore, ngarkesën vjetore si dhe çdo dokumentacion që i bashkëngjitet Rregullores së programit të studimit MPPS-PSA/PSSH. Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DPPS. Bazuar në kuadrin ligjor kjo njësi arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK si dhe marrëveshjet kontratë të nënshkuara me stafin akademik në përfundim të procesit të rekrutimit.</p> <p>Shih dokumentacionin e dosjes në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe praktikave të rekrutimit (më tej GVJ).</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT dhe neni 44, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT</i></p>
	<p style="text-align: right;">Përbushet kryesisht</p>



Shkalla e përbushjes së standardit				X
------------------------------------	--	--	--	---

**Standardi IV.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

**Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m<sup>2</sup>, 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.

Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik, UT-ja ka ngritur në strukturën organizative të saj Sektorin e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë si dhe komisionin përkatës për promovimin e stafit akademik, që administron dosjet me informacion të plotë, në lidhje me kërkimin shkencor dhe promovimin akademik të personelit akademik. Ndërkohë që në Departamentin e Punës dhe Politikave Sociale, personeli akademik depoziton të dhëna mbi arritjet akademike, periodikisht Koordinatorin e programit MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi mbledh dhe menaxhon dokumentacionin e stafit të angazhuar në mësimdhënie, si CV, programe mësimore, ngarkesa e stafit të brendshëm dhe të jashtëm. Të gjitha nevojat e stafit në funksion të realizimit të planit mësimor, mësimdhënies dhe detyrave të tjera administrative, që stafi akademik ka detyrimin të kryejë brenda vitit akademik, i referohen personelit të administratës, sipas nevojës dhe sipas procedurës, përbushen shërbimet e kërkuara. Kështu, kërkesat për mjete pune, referohen tek punonjësja e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe së fundi në Zyrën e Financës, që i referojnë tek administratori i FSHS-së. Pasi firmosen, kalojnë më magazinë dhe bëhet shpërndarja e materialeve të kërkuara, tek pjestari i stafit të brendshëm që i ka kërkuar ato. Personeli administrativ, është gjithnjë në mbështetje të stafit akademik në realizimin e veprimtarisë së përditshme mësimore dhe kërkimore, Nevojat për njoftime dhe publikime për programin e MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, por jo vetëm, referohen nga departamenti tek Sektori i IT-së në FSHS.

*Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.20 Modeli i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.*

**Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.


Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS, DPPS kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përbushur misionin e UT dhe janë të angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që realizon dhe administron programin e

	<p>studimit MPPSA. UT-ja në dokumentet bazë të veta, shpreh angazhimin për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik, duke inkurajuar kërkim shkencor, promovimin dhe trajnimin e personelit akademik në universitetet perëndimore me të cilat ka lidhur marrëveshje për shkëmbim të stafit akademik për trajnime dhe mësimdhënie. Në funksion të këtij angazhimi, është hartuar dhe është duke u zbatuar strategjia e ndërkombëtarizimit të universitetit, pjesë e strategjisë së UT-së 2018-2023 dhe një strategji katërvjeçare për kërkimin shkencor. Fakulteti Shkencave Sociale është angazhuar në kualifikimet dhe pjesëmarrjen e pedagogëve të DPPS, përmes pjesëmarrjes në konferenca të organizuara si brenda institucionit edhe jashtë tij.</p> <p>DPPS ka zhvilluar që prej vitit 2010, konferenca në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me tematika në fushat e studimit që departamenti mbulon Njëkohësisht stafi është mbështetur prej UT/FSHS-së edhe në konferenca ndërkombëtare përtej institucionit, si dhe në angazhimin në projekte të ndryshme, për ngritjen e kapaciteteve që ndikojnë direkt mësimdhënien, por edhe punësimin e studentëve. Në kuadrin e nxitjes së kërkimit shkencor, në zbatim të elementeve të planit strategjik të DPPS dhe programit strategjisë së programit MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, si dhe në kuadrin e strategjisë së ndërkombëtarizimit, kualifikimi i stafit ka marrë dimensione të reja.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 2.24 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GJV konstatojmë se UT, FSHS, DPPS kanë mundësuar programe specifike për përdorimin e metodave më të përparuara të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik dhe të personelit mësimor-shkencor. Në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të UT-së, 2018-2023, UT-ja synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënieje bashkëkohore sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare, deklaratës së Bolonjës dhe Komizës Shqiptare të Kualifikimit. Për artitjen e këtij qëllimi, stafi akademik inkurajohet në mënyrë të vazhduar prej të gjitha niveleve drejtuese, për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja.</p> <p>Në varësi të nevojave akademike, UT-ja ka prodhuar udhëzimet e nevojshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme edhe inovative në funksion të lehtësimit dhe pasurimit të mësimdhënies, në bazë të fushës së studimit.</p> <p>Është për t'u vënë në dukje se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19-të, procesi i mësimdhënies u bë i mundur të realizohet në distancë, duke qenë i mbështetur nga rregulloret dhe udhëzimet e nevojshme për stafin dhe studentët. Njëkohësisht në nivel institucioni janë organizuar trajnime për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, si për përdorimin e programit Moodle, në të cilin kanë marrë pjesë edhe anëtarë të stafit akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor dhe Master.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 1.15 Udhëzues UT për përdorimin e</i></p>

	<i>sistemit të mësimit në distancë, 1.17 Vendim për disa shtesa në udhëzuesin e UT- Për zhvillimin e mësimit në distancë.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DPPS janë të angazhuar maksimalisht për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë, që dëshmohet edhe në strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale, të programit të studimit MPPSA për periudhën kohore 2020-2024, që nënvizohet se është krijimi i profesionistëve të kualifikuar, të vlefshëm dhe të përgjegjshëm për të bërë ndryshimin pozitiv në mirëqënien e individëve, përmes transmetimit të dijeve dhe aplikimit të kërkimit shkencor. Planifikimi i kohës së punës për secilin anëtar të stafit është i shpërndarë në të tre elementet përbërës së saj: realizim i procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve (sipas bazës ligjore në fuqi), në bazë të Udhëzimit të MASR Nr.29, datë 10.09.2018.</p> <p>Ndarja e ngarkesës mësimore realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit, për secilin anëtar të stafit akademik të programit Master Profesional në përputhje të plotë me kompetencat profesionale të secilit pedagog dhe përparësive në punën kërkimore, që secili parashikon individualisht dhe në nivel Departamenti, Fakulteti apo Universiteti, në fillim të çdo viti akademik. Kjo siguron një shpërndarje optimale të ngarkesës së punës dhe specifikisht të ngarkesës mësimore ndërmjet stafit, duke e orientuar atë në këtë mënyrë në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. Marrëdhëniet e punës midis UT-së dhe të gjitha kategorive të stafit, rregullohen me kontratat e punës, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të drejtat dhe detyrimet për secilën kategori të stafit të UT-së, janë në përputhje të plotë me statutin dhe rregulloren e UT-së.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MPPSA 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.20 Modeli i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m <sup>2</sup> , 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe

	<p>70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Në mjediset e FSHS-së DPPS-ja ka në shfrytëzim mjedise leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, gjatë orëve të pasdites, orari 14:00-20:00; sallën për realizimin e konferencave, të pajisur me videoprojektor, amfiteatrin, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktivitetëve doktorale, e pajisur me mjetet , përkatëse, në katin e dytë; të gjitha klasat e leksioneve dhe seminareve kanë të instaluar videoprojektorë. Në dispozicion të secilit pedagog të angazhuar në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi janë laptopi personal, PC statik, printer dhe mjedis të përshtatshëm për të punuar dhe ruajtur materiale dhe dokumentacion, i lidhur me mësimdhënien dhe për mësimdhënien. Pajisjet kompjuterike në ndërtesë, janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion ' të mësimdhënies. Mjediset e sekretarisë së departamentit dhe sekretarisë mësimore, janë të pajisura me teknologjinë e duhur në funksion të mësimdhënies, proceseve të regjistrimit dhe hedhjes së të dhënave për studentët, prodhim dokumentacioni dhe bazë të dhënash; edhe zyrat e stafit akademik janë të pajisura me mjetet e nevojshme të mësimdhënien dhe përshpejtojnë proceset e komunikimit brenda dhe jashtë institucionit. Në shesh-pushimet e kateve janë të instaluar ekranë që shfaqin sistematikisht informacione shumë të rëndësishme për mësimdhënien, si njoftime, orarin mësimor, informacione lidhur me veprimtari shkencore, konferenca, trajnime, diskutime, leksione të hapura, paraqitje publike tekstesh, informacione zyrtare për studentët dhe stafin. Gjithashtu në varësi të zhvillimeve të reja FSHS-ja në kërkesat e tij buxhetore, parashikon në mënyrë të vazhdueshme pajisjen e stafit dhe mjediseve me pajisje elektronike dhe teknologji bashkëkohore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, 4.13 Të dhëna për infrastrukurën në funksion të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m2, 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>DPPS-ja ka në shfrytëzim mjedise leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, gjatë orëve të pasdites, orari 14:00-20:00; salla për realizimin e konferencave, e pajisur me videoprojektor, amfiteatri, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktivitetëve doktorale, e pajisur me mjetet , përkatëse, në katin e dytë; të gjitha klasat e leksionit dhe seminarit kanë të instaluar videoprojektorë. Në dispozicion të secilit pedagog të angazhuar në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi janë laptop personal, kompjuter statik, printer dhe mjedis të përshtatshëm për të punuar dhe ruajtur materiale dhe dokumentacion, i lidhur me mësimdhënien dhe për mësimdhënien. Pajisjet i kompjuterike në ndërtesë,</p>



	<p>janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion ' të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, 4.13 Të dhëna për infrastrukurën në funksion të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m<sup>2</sup>, 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>DPPS-ja ka në shfrytëzim mjedise leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, gjatë orëve të pasdites, orari 14:00-20:00; salla për realizimin e konferencave, e pajisur me videoprojektor, amfiteatri, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktiviteteve doktorale, e pajisur me mjetet , përkatëse, në katin e dytë; të gjitha klasat e leksionit dhe seminarit kanë të instaluar videoprojektorë. Në dispozicion të secilit pedagog të angazhuar në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi janë laptop personal, kompjuter statik, printer dhe mjedis të përshtatshëm për të punuar dhe ruajtur materiale dhe dokumentacion, i lidhur me mësimdhënien dhe për mësimdhënien. Pajisjet i kompjuterike në ndërtesë, janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion ' të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, 4.13 Të dhëna për infrastrukurën në funksion të programit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>Në RVB është evidentuar nevoja e ngritjes së një laboratorit të teknologjisë së informacionit, me qëllim që të mbështesë studentët në përgatitjen e punëve individuale apo në grup, në kuadër të përfshirjes së aftësimeve teknologjike të informacionit dhe komunikimit (më tej ITC) edhe në programin e studimit MPPSA.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, 4.13 Të dhëna për infrastrukurën në funksion të programit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se , së pari, UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m<sup>2</sup>, 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep</p>

	<p>mundesinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Së, dyti, për realizimin e praktikave profesionale FSHS ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private si dhe organizata jofitimprurëse. Praktikave profesionale zhvillohen në institucione të natyrës së sipërpërmendur sipas profilit të përgatitjes së studentëve. Ata shoqërohen dhe udhëhiqen nga pedagogët e caktuar apo staf i rekrutuar vetëm për praktikat profesionale të studentëve, për t'i ndjekur në bashkëpunim me personin mbikqyrës në institucion. Grupet mësimore kanë një numër studentësh në varësi të institucionit dhe kapaciteteve akademike të DPPS për t'i mbikqyrur dhe udhëhequr. Praktikave të studentëve janë realizuar sipas pritshmërive dhe rezultatet kanë dëshmuar vlerën e madhe të tyre, ashtu si janë vlerësuar nga studentët si veprimtari të kryera në kushte optimale.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, 3.17: List e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale, 3.19 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, 3.21 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale, 4.13 Të dhëna për infrastrukurën në funksion të programit</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS, DPPS mbështetur në Statutin e UT-së kanë kapacitete si më tej: godina 4,500 m<sup>2</sup>, 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DPPS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfrytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve/studentëve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Studentët përdorin në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore, brenda FSHS, me personel në dispozicion, me orar 08.00-18.00, i cili është i mundshëm për t'u përdorur nga studentët, gjithashtu biblioteka është në njëjtin mjedis ku studentët e MPPS të dy profileve zhvillojnë programin mësimor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.28: Rregullore e bibliotekës, 2.29: Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxheti për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukurën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS, DPPS u kanë krijuar studentëve MPPS mundësitë për të përdorur literaturën bazë të detyrueshme për çdo disiplinë apo lëndë të programit mësimor, në trajtën e teksteve mësimore,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

54

<p>nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>përmbledhjeve të leksioneve të përgatitura nga lektorët e disiplinave apo lëndëve. Literatura bazë gjendet në bibliotekën e FSHS, në Bibliotekën Kombëtare dhe në Librarianë Universitare. Biblioteka e FSHS është e pajisur me shumë tituj në gjuhën shqipe, në gjuhë të tjera të huaja, me literaturë në trajtën e librave, revistave shkencore, materialeve PDF, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të gjitha modulet dhe veprimtaritë mësimore, sipas specifikave të programit MPPS me dy dy profile.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.29: Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukurën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS për stafin akademik dhe studentët ofrojnë shërbimin e bibliotekës on-line.</p> <p>Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka finalizuar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR për qasje të drejtpërdrejtë në Bibliotekën digjitale JSTOR në të gjithë godinat dhe rrjetin e UT-së.</p> <p>Biblioteka digjitale JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina. Kjo bibliotekë digjitale u krijua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të konvertojnë punimet e shtypura në format digjital, të cilat do të ruhen për brezat e ardhshëm. Libraria është e aksesueshme në adresën: <a href="https://www.jstor.org/">https://www.jstor.org/</a>. Gjithashtu, në web-in e UT-së personeli akademik dhe studentët, kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line ULIBRARY, përmes të cilës eksplorohet në fusha të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës, i cili gjendet po në këtë faqe dhe ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në përdorim është gjithashtu faqja Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës ku përditësohen tekste dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.Net. Studentët kanë kërkuar për materiale/tekste, artikuj digjitalë, sipas manualit të librarisë digjitale, i cili ka shërbyer për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, duke aksesuar këtë shërbim në linkun: <a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a>.</p> <p>Për Bibliotekën elektronike online është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)), mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor, EIFL/ Informacioni Elektronik për Biblioteka dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ koordinatori për projektin ERA 2012, ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga e-library Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor &amp; Francis. Digjitalizimi i standartizuar dhe i unifikuar i librit dhe tekstit mësimor në UT dhe FSHS mbetet detyrë për t' u realizuar në të ardhmen.</p> <p>UT dhe FSHS i ka hapur rrugën edhe investimeve të reja në infrastrukurën teknologjike për të rritur mundësitë e shfrytëzimit pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik bibliotekave apo faqeve mësimore elektronike.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.28: Rregullore e bibliotekës, 2.29:</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

55

	<i>Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS e kanë pajisur bibliotekën e tyre me PC në dispozicion të studentëve. Në RVB parashtrohet nevoja e ngutshme për ngritjen e një laboratorit të mirëfilltë ITC, që do t'u shërbejë më mirë studentëve, edhe atyre të MPPS për realizimin e detyrave apo projekteve, individuale apo në grup. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.28: Rregullore e bibliotekës, 2.29: Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se FSHS për hartimin e draft-buxhetit vjetor, mbledh prej Njësisë Bazë nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës duk e e përditësuar fondin ekzistues me botime të kohës, në mbështetje të programit të studimit. DPPS përcjell kërkesat e anëtarëve të departamentit për literaturë dhe tituj, sikurse edhe abonime në burime online, në projekt-buxhetin e departamentit Në RVB sugjerohet marrja e masave prej strukturave përgjegjëse, për të shtuar fondin e librave me tituj të rinj bashkëkohorë, në funksion të programit të studimit, sikurse edhe realizimin e iniciativave për përkthime të literaturës së sugjeruar, në mënyrë që studentët të shfrytëzojnë sa më shumë literaturë, edhe të mund të përdorin më shumë dhe lehtësisht leksione në gjuhën shqipe. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.29: Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS.</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se biblioteka e FSHS ka 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi dhe u jep mundësinë përdoruesve/studentëve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE. Studentët përdorin bibliotekën mësimore, brenda FSHS, me personel në dispozicion, me orar 08.00-18.00, gjithashtu biblioteka është në njëjtin mjedis ku studentët e MPPS të dy profileve zhvillojnë programin mësimor. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. 2.28: Rregullore e bibliotekës, 2.29: Informacion për bibliotekën, 2.30: Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës, 2.31: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 4.10: Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHS..</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

56



**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se në zbatim të Ligjit Nr. 80 2015, Neni 101, Universiteti i Tiranës dhe FSHS-ja, mban në formë të shkruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Regjistrin themeltar të studentëve,</li> <li>➤ Regjistrin e arritjeve akademike, ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik,</li> <li>➤ Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</li> </ul> <p>Sekretariatë mësimore të departamenteve i plotësojnë këto tre regjistra edhe në formë elektronike. Sekretaria është struktura përgjegjëse për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me arritjet akademike deri në diplomimin e studentëve. Krahas sekretarisë mësimore, në ndihmë të këtij procesi në UT dhe FSHS funksionon Sektori i IT-së dhe Sistemi kompjuterik, i cili është një sistem modular, që operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish (aktualisht jo në kushte teknike pune). Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Secili grup përdoruesish, është i autorizuar ta përdorë në mënyrë të përgjegjshme sistemin. Sistemi i menaxhimit të informacionit është një platformë digjitale moderne, që iu mundëson, së pari, studentëve që të kenë në çdo kohë mundësinë për të aksesuar ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore dhe sportive në UT brenda dhe jashtë procesit mësimor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, 4.15: Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT-ja ka hartuar dokumenta që rregullojnë procedurat e menaxhimit të informacionit brenda institucionit. Moduli për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit ende nuk është pjesë e platformës së menaxhimit të informacionit, por strukturat përgjegjëse për administrimin e këtij informacioni, e ruajnë këtë informacion në tabela excel apo word dhe e vendosin në përdorim, sipas kërkesave për shfrytëzimin e këtij materiali. Sektori i burimeve njerëzore dhe protokoll arkivës menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve dhe të regjistrave themeltarë, ndjek procedurat për shpërndarjen dhe grumbullimin e kontratave të punës për të gjithë punonjësit e FSHS/DPPS-së, menaxhon afatet kohore të kontratave të punës për çdo punonjës, hedh të dhënat personale të çdo punonjësi në regjistrat themeltarë, nxjerr të dhëna nga dosjet personale ose librezat e punës për çdo punonjës, kur kërkohen për evidence nga strukturat respektive. Nga RVB vlerësohet se ka rinisur të funksionojë sistemi i menaxhimit të informacionit në UT.</p>



	<p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.9: Privatësia në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 4.11: Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personeli akademik në 5 vitet e fundit, 4.12: Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se sektori i IT-së siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi. Çdo burim informacioni në sistem shoqërohet me dokumentacionin administrativ përkatës sipas procedurave të UT-së, të përcaktuara në rregulloren përkatëse të UT- së.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm, mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Zyra IT</li> <li>✦ Përgjegjës Departamenti</li> <li>✦ Sekretare</li> <li>✦ Krye Sekretare</li> <li>✦ Studentët</li> <li>✦ Pedagogët</li> <li>✦ Rektor</li> </ul> <p>Programi i Transparencës për Universitetin e Tiranës dhe rregullorja e UT-së për mbrojtjen e të dhënave personale krijojnë kushtet e nevojshme për të përfituar akses të dedikuar në informacione e dokumente, për stafin akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët e programit të studimit, të cilët mbi bazën e kërkesave të adresuara zyrtarisht, përfitojnë mundësi për të përdorur informacionin e kërkuar.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.9: Privatësi në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se personeli akademik dhe studentët kanë në përdorim adresa zyrtare në @unitir.edu.al, dhe përdorin platformën Microsoft Teams për të komunikuar dhe marrë informacion në faqen e Institucionit: <a href="https://unitir.edu.al/aksesi-online">https://unitir.edu.al/aksesi-online</a>. UT-ja ka hartuar një dokument të posaçëm, ku përcakton modalitetet e marrjes së shërbimeve dhe krijimin e hapësirave të komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve, në procesin e mësimdhënies, por jo vetëm</p> <p>Sistemi kompjuterik i UT-së, është një sistem modular, i cili operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Çdo hyrje informacioni në sistem, shoqërohet me dokumentacionin administrativ përkatës, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e UT- së. Ky sistem ofron mundësi komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve, konkretisht studentët vlerësojnë</p>

	<p>programin mësimor nëpërmjet pyetësoreve në sistem, ashtu si personeli akademik nëpërmjet sistemit përcjell rezultatet e provimeve tek studentët. Këto shërbime kane qene thelbesore gjatë periudhës së pandemisë Covid -19, sepse e gjithë veprimtaria e DPPS u realizua përmes platformës Microsoft Teams, u zhvillua mësimi në distancë, përfshirë pajisjen e studentëve me leksione dhe literaturë, ngarkimin e punëve të pavarura dhe të grupit, projektet e kursit, provime të pjeseshme dhe finale, vlerësimi përfundimtar, sikurse edhe trajnime, mbledhje, komunikime për çështje të mbarëvajtjes së departamentit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore, www.unitir.edu.al.</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se sistemi kompjuterik i Universitetit të Tiranës, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Sipas nevojave sistemi mundëson dhe prodhon raporte statistikore, mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit etj. Sistemi informatik në FSHS dhe platformat e përdorura, ka siguruar raportime dhe monitorim në kohë reale të procesit të mësimdhënies, në të gjithë hallkat e tij, e nevojshme për periudhën e mësimdhënies, kontrollit dhe vlerësimit në distancë, për të krijuar raporte reale mbi ecurinë e proceseve në të gjitha nivelet.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT ka një faqe web të posaçme ku publikohen informacione që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe veprimtaritë e ndryshme. Ky informacion publikohet në faqen online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. FSHS ka faqen e vet të web-it, ku paraqitet në mënyrë analitike programet e studimit, departamentet, kërkimi shkencor, informacione, njoftime dhe botimet. Të gjitha informacionet e publikuara respektojnë politikat institucionale të publikimit të informacionit për të drejtën e informimit. Një faqe e web-it merret posaçërisht me Programin e Transparencës.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore. www.unitir.edu.al</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="612 1693 767 1765">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="767 1693 979 1765">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 1693 1192 1765">Përmbushet në pjesë</th> <th data-bbox="1192 1693 1394 1765">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="612 1765 767 1825"></td> <td data-bbox="767 1765 979 1825"></td> <td data-bbox="979 1765 1192 1825"></td> <td data-bbox="1192 1765 1394 1825" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet në pjesë	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet në pjesë	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi IV.6**



**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT-ja, harton në mënyrë periodike Raportin Financiar të institucionit, i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student, në nivel universiteti. Hartimi i buxhetit të Universitetit fillon nga njësi bazë pra që nga departamenti, duke patur parasysh nevojat e secilit prej tyre, por plotësimi i nevojave varet nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo departament dhe fakultet. Gjithsesi, ruhen balancat midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke ndjekur një politikë favorizuese për ato fakultete që krijojnë më shumë të ardhura, por pa diskriminuar fakultetet e tjera të cilët për nga natyra e tyre gjenerojnë më pak të ardhura dhe duke reflektuar në çdo rast nevojat për ndryshime në buxhet.</p> <p>UT-ja nuk harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, por harton një kosto mesatare studenti në nivel Universiteti. Në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit, si dhe në varësi të kërkesave të njësive kryesore, UT-ja harton plane afatmesme buxhetore. Gjithashtu, UT-ja ka miratuar edhe procedura dhe instrumente në mbështetje të stafit akademik, për arritjen e objektivave të mësimdhënies me standarde bashkëkohore dhe kualifikimit të mtejshëm të tij, së bashku me udhëzimet përkatëse mbi mënyrën e përdorimit të tyre.</p> <p>FSHS harton planin buxhetor të përvitshëm, mbështetur në nevojat e identifikuar dhe kërkesat e stafit akademik, ndihmësakademik të departamenteve. DPPS paraqet çdo vit një plan të tillë në përpjesëtim me nevojat e stafit për vitin akademik përkatës Gjithashtu, FSHS harton plane financiare për të buxhetuar periudha afatmesme në përputhje me ciklet e kohëzgjatjes së një programi studimi, pra afati 3-vjeçar. Planet i nënshtrohen konsultimit dhe diskutimit në dekanat, për t'u përcjellë më pas në Senatit Akademik dhe miratohen përfundimisht në Bordin e Administrimit të UT-së. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.32: Të dhëna për infrastrukurën, 2.34: Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zërit të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se në fillim të çdo viti buxhetor (joakademik), bëhet shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në UT, në përputhje të plotë me strukturën e Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza: Faza e parë është hartimi dhe miratimi i buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MASR. Faza e dytë është hartimi dhe miratimi i buxhetit nga të ardhurat e Universitetit. Hartimi dhe miratimi në total i buxhetit të Universitetit, pavarësisht nga burimet e financimit të tij, fillon nga njësitë bazë, kryesore dhe ndihmëse të tij. Departamentet e hartojnë projekt buxhetin e tyre dhe më pas ato koordinohen dhe miratohen në nivel fakulteti në dekanatin përkatës, më pas e paraqesin atë në Rektorat. Projekt buxheti paraqitet për shqyrtim dhe miratim në organet kolegjiale, fillimisht në Rektorat, në Senat dhe përfundimisht në Bordin e Administrimit. Gjithashtu Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale harton një plan</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

60

	<p>financiar buxhetor të përbashkët për programet e studimit që mbuloohen nga departamenti, i cili pasi miratohet nga departamenti, integrohet në planin financiar të institucionit, që si rregull përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.32: Të dhëna për infrastrukturën, 2.34: Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se Universiteti i Tiranës, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar të jashtëm dhe të brendshëm. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm realizohet kryesisht prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MASR. Referuar organigramës së Universitetit të Tiranës dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, UT-ja ka ngritur në strukturën e vet Sektorin e Auditit të Brendshëm, i cili është në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit. UT-ja kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar, i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si dhe ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të UT pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Administratorja e FSHS-së raporton periodikisht për mënyrën e realizimit të buxhetit sipas zërave të parashikuar dhe të realizuar.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.32: Të dhëna për infrastrukturën, 2.34: Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se dokumenti i analizës financiare hartuar nga FSHS dhe UT, në fund të çdo viti buxhetor, miratohet e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivën dhe protokollin. Analiza nuk përshkruan vetëm periudhën korrente, por ka edhe një natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit në periudhat ushtrimore të shkuara, çka do të thotë, se të jep mundësinë për gjykuar mbi raporte financiare të tre viteve të kaluara akademike dhe mundësi të planifikimit të ndërhyrjeve të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të secilit program studimi, për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Mbi bazën e rezultateve të këtij raporti, hartohet dhe miratohet plani financiar për vitin në vijim.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.32: Të dhëna për infrastrukturën, 2.34: Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se burimet e financimit të Universitetit të Tiranës, si institucion publik, janë shprehur dhe përcaktuar në dokumentet baze të institucionit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✦ granti i politikave të zhvillimit;</li> <li>✦ granti i mësimdhënies;</li> </ul>

ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>✳️ granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese</p> <p>Financimi i Universitetit, mbështetur në modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe zbatimi i skemës së financimit, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin</p> <p>Më qëllim mirëmenaxhimit e këtyre fondeve dhe sigurimit e një qëndrueshmërie financiare, UT shfrytëzon të gjitha burimet e mundshme të financimit, në përputhje me bazën ligjore dhe statusin e institucionit. Në analizën financiare vjetore të FSHS-së, shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare në nivel fakulteti, në përputhje me objektivat financiarë dhe politikat në nivel universiteti.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.32: Të dhëna për infrastrukturën, 2.34: Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit FSHS.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesësisht</b>
			X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se Universiteti i Tiranës mbështetet në një traditë të krijuar si universiteti i parë në vend në ofrimin e programeve të studimit të cilat reflektojnë kërkesa të reja të tregut të punës. Në Universitetin e Tiranës dhe në FSHS procesi i pranimit të studentëve e deri në përfundimin e plotë të ciklit të studimit, mbështetet në procedura të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Për çdo vit akademik, pranimi i studentëve kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Kriteret e pranimit propozohen nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe më pas miratohen nga Senati Akademik. Gjatë periudhës së zhvillimit të programit studentët kanë në dispozicion për informacione dhe shërbime të vazhdueshme struktura të tjera të posaçme siç janë Zyra e Informacionit, Zyra e Karrierës, Zyra e Shërbimeve dhe IT-jadhe Sekretaria Mësimore.

	<p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se në Statutin e UT përshkruhen qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve të cilat bazohen në parimet e barazisë. Rregullorja e UT dhe FSHS përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga rregjistrimi i tyre, deri në përfundim të studimeve, apo procedura dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë studentët të cilët aplikojnë dhe më pas shpallen fitues në programin e studimit MPPSA me profile Shëndetësi dhe Arsim.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit,</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen nga Statuti i UT dhe Rregullorja e Transparencës, aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit apo në faqen zyrtare të FSHS për kandidatët për studentë, studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë ciklit akademik, të cilët arrijnë lehtësisht tek informacioni që iu duhet.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit,</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me FSHS dhe Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale si njësi bazë përgjegjëse, në fillim të vitit akademik harton dhe publikon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Pranimi në programin e studimit bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara nga Senati Akademik për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e</i></p>

	<p>kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit,</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS dhe DPPS si njësi kryesore e programit realizojnë komunikimin me publikun e interesuar nëpërmjet disa formave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pasqyrimin në faqet e web -it të UT dhe FSHS dhe seksionit të Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale në lidhje me përmbajtjen, karakteristikat dhe kriteret e pranimit në këtë program studimi,</li> <li>• organizimit të takimeve promovuese me studentët e programit BA të FSHS. Qëllimi i realizimit të takimeve është informimi i studentëve, të cilët mbarojnë ciklin e parë të studimeve, rreth karakteristikave të programit të masterit, lëndët që zhvillohen në të, mundësitë për punësim si dhe kriteret e pranimit.</li> <li>• Organizimit të ditëve të hapura</li> </ul> <p>Përvoja ka ndihmuar që programi i studimit të ketë vazhdimësi dhe cilësi mjaft të mirë të studentëve në hyrje dhe në përfundim të studimeve.</p> <p>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimit, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Përcjellja e informacionit të plotë përmes rrugëve formale të komunikimit me studentët, përcaktohet në rregulloren e UT. Pasi fiton statusin e studentit, çdo student pajiset me adresën e tij elektronike në formatin emër.mbiemër@unitir.edu.al, që është një ndër format e komunikimit midis tij dhe institucionit.</p> <p>Në Rregulloren e UT, e cila është e aksesueshme për studentët në faqen e UT, përcaktohen qartë kushtet dhe procedurat që duhet të plotësojnë studentët për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin. Organizimi i vitit akademik, datat e</p>



	<p>fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve shpallen nga Dekani në fillim të vitit akademik. Ato publikohen edhe në faqen Web të institucionit ku mund të aksesohen nga studentët. Website i FSHS është një mjet shumë i rëndësishëm ku publikohen informacione të përditësuara mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Po ashtu, publikohet edhe orari mësimor (me ditën, lëndën, sallën, orën e zhvillimit të mësimit dhe pedagogun e lëndës) në mjediset e FSHS</p> <p>Për çdo lëndë pedagogu përgatit syllabusin e lëndës, i cili përmban informacion të detajuar mbi literaturën që do të përdoret, format e kontrollit të dijes gjatë lëndës dhe vlerësimit të studentëve. Syllabusi u prezantohet studentëve në fillim të semestrit. Komunikimi i personelit akademik me studentët bëhet i mundur edhe përmes orareve të pritjes, të afishuara në mjediset e FSHS. Komunikimi i personelit akademik me studentët bëhet i mundur edhe përmes orareve të pritjes, të afishuara në ambiente FSHS. Listën e notave dhe krediteve të fituara apo vërtetime të tjera në lidhje me përparimin akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin të studentit realizohet nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se është sekretaria mësimore që informon mbi kriteret e procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme, bazuar në Statutin e UT-së dhe rregulloren e transferimeve, parashikuar në aktet e brendshme rregullues. Informimi bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të FSHS-së si dhe njoftimeve të afishuara në mjediset e fakultetit dhe rrjeteve sociale. FSHS u ofron studentëve mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël, programeve të përafërta, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, etj., duke ndjekur procedurat dhe kriteret e vendosura nga institucioni. Me urdhër të dekanit në Departament e Punës dhe Politikës Sociale ngrihet komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i cili miratohet nga Dekani, dhe shqyrton kërkesat e studentit për njohjen e kualifikimeve të mëparshme</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale e realizon informimin e studentëve në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në disa mënyra.</p>

	<p>Rregullorja e UT, e FSHS dhe Rregullorja e programit të studimit Master Profesional ne Punë Sociale të avancuar, me drejtim arsim dhe shëndetësi, përshkruajnë qartësisht procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve të studentëve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, ku përfshihen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimi i tyre e deri te ankimi. Mbështetur në rregulloret e sipërpërmendura, çdo pedagog përcakton në syllabusin e lëndës që harton rregulla apo specifika të provimeve, peshën (përqindjen) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literaturën, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, ditën apo javën e provimit, orën dhe sallën e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve me notë. Të gjitha këto informacione iu përcillen studentëve që ndjekin programin nga vetë pedagogu në auditor gjatë paraqitjes së syllabusit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre rganizative, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për MPPSA, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se rregullorja e UT-së parashikon qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programet e studimit Master Profesional.</p> <p>Për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur. Rregullorja e programit të studimit në Master Profesional Punë Sociale dhe Udhëzuesi i Punimit të Mbrojtjes së Diplomës, specifikon procedurat specifike për zhvillimin e provimit të diplomës së këtij programi. Sekretaria mësimore, është një tjetër burim i rëndësishëm informacioni, ku studentët mund të drejtohen në lidhje me këto procedura dhe të marrin informacion.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.11 Rregullore e diplomimit, 4.5 Paketa e punimit të diplomë dhe pyetjet e provimit të formimit MPPSA</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale si njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit në fillim të çdo viti punon intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë duke organizuar disa veprimtari informuese në formën e takimeve të hapura me studentët e diplomuar në ciklin e parë të të studimeve në FSHS dhe më gjerë, ku paraqiten informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qënë të hapur ndaj diskutimeve apo sugjerimeve që mund të shfaqen në këto takime.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale,</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="596 1823 751 1890">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="751 1823 963 1890">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="963 1823 1176 1890">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1176 1823 1385 1890">Përmbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="596 1890 751 1933"></td> <td data-bbox="751 1890 963 1933"></td> <td data-bbox="963 1890 1176 1933"></td> <td data-bbox="1176 1890 1385 1933">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo						
			X						

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

**Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.

Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se studentët e Programit Master Profesional Punë Sociale nëpërmjet faqes zyrtare web të UT dhe FSHS kanë mundësi që në fillim të çdo viti akademik të përfitojnë informacionin e hollësishëm në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarjen e tij në semestra, periudha e provimeve. Informacioni në web në lidhje me organizimin dhe programet që ofron departamenti, krijon mundësinë për të marrë informacionin e duhur në lidhje me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi.

Gjithashtu, që prej regjistrimit dhe fitimit të statusit të studentit e në vazhdim, përgjatë gjithë kohës studentët informohen në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin e programit të studimeve përmes Sekretarisë Mësimore të departamentit.

Sipas RVB është detyrë e koordinorit të programit që të realizojë takime me ta, gjatë të cilave i informon në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, lëndët që do të frekuentojnë gjatë një semestri, oraret, klasat e kështu me radhë.


*Ref. dokumentave të atashuar: 4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale,*

**Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS dhe Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale si njësi bazë, vendosin në dispozicion të studentëve gjithë informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e universitetit dhe të fakultetit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, syllabuset, organizimin e lëndëve, etj. Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme nga studentët në disa rrugë si:

- ✚ Udhëzues dhe informacione të printuara në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve;
- ✚ Njoftime dhe udhëzues të shpallur në mjediset e përcaktuara të FSHS (njoftime të ndryshme, oraret e mësimor, oraret e provimeve, etj).
- ✚ Në format elektronik në website-n e universitetit, i cili është i arritshëm nga të gjithë studentët; në adresa interneti dhe faqe web- i lehtësisht të arritshme për ta.

Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati dhe Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, u bëhen me dije studentëve në



	<p>forma të ndryshme si, takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të universitetit, njoftimeve në website-n e UT dhe FSHS.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se Personeli akademik i Departamenti të Punës dhe Politikës Sociale, Koordinator i programit dhe Zyra e Karrierës u sigurojnë informacione dhe këshillim studentëve në lidhje me mundësitë e punësimit në tregun e punës.</p> <p>Këto njësi shërbejnë si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Nga takimi në FSHS me anëtarët e DPPS u evidentua se sfida e këtij sektori është të vendosë bashkëpunime me subjekte të ndryshme që operojnë në tregun shqiptar duke organizuar një sërë aktiviteteve gjatë vitit akademik, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët e FSHS-së.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, 4.14 Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit, 4.15 Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar,</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se UT dhe FSHS disponojnë kapacitete dhe mjete logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mesimor dhe studentët marrin informacion, i cili është lehtësisht i aksesueshëm dhe i plotë në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet strukturave dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit, qoftë përmes komunikimit verbal dhe zyrtar në faqen web të FSHS, qoftë edhe vizualisht, në mjediset e brendshme dhe të jashtme të FSHS.</p> <p>Studentëve iu vihet në dispozicion user-name dhe passwordi personal për përdorim e sistemit informatik (platforma Microsoft Teams gjatë mësimin online), ku marrin informacionet në lidhje me procesin mësimor: oraret me klasat ku zhvillohen leksionet, njoftimet për zëvendësimet e leksioneve përditësohen vazhdimisht në këtë hapësirë. Ky informacion i plotë dhe i detajuar ofrohet edhe në faqen web e FSHS-së; për më tepër, në mjediset e sekretarisë mësimore të FSHS-së, përpos shërbimeve të tjera për studentët, afishohen të gjitha informacionet e përditësuara. Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë në lidhje me organizimin e mësimin përmes orarit të afishuar në mjediset e dukshme të FSHS-së.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 4.1 Korniza konceptuale e programit të studimit MPPSA, 4.2 Plani mësimor i programit të studimit MPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë Sociale, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se të gjitha strukturat në funksion të realizimit të programit të studimit, duke filluar që nga strukturat drejtuese dhe personeli akademik i Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale, personeli ndihmës akademik i departamentit, sekretaria mësimore, zyra e informacionit, zyra e karrierës dhe strukturat më të larta drejtuese të fakultetit me studentët janë çdo rast të disponueshëm të lehtësojnë jetën e tyre studentore.</p>

	Ref. dokumentave të atashuar: 1.10 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 1.15 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë, 1.17 Vendim për disa shtesa në udhëzuesin e UT-Për zhvillimin e mësimin në distancë, 2.5 Struktura organizative e FSHS, 3.11 Vendimi për caktimin e koordinatorit të programit MPPSA, 3.12 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit MPPSA, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a> .		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.

Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se UT përmes stafit ndihmës akademik, mbështetur në Statutin e vet, disponon dhe mban statistika vjetore mbi: numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi; numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë; tërheqjet e studentëve nga programi; transferimet, ekuivalentimet, largimet e studentëve para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve; të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Grupi i ekspertëve konstatoi gjatë vizitës se, bazuar tek Rregullore e UT, Sekretaria Mësimore e FSHS-së, i dispononte këto të dhëna në formë të shkruar në:

- ✦ regjistrin themeltar të studenteve,
- ✦ regjistrin e arritjeve akademike,
- ✦ regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave

Për programin e studimit Master Profesional Punë Sociale e avancuar me Profile: Punë Sociale në Arsim dhe Punë Sociale në Shëndetësi për vitin akademik 2018-2019 janë pranuar 68 studentë, 2019-2020 57 studentë dhe 2020-2021 56 studentë. Në dokumentet e atashuar nuk ka të dhëna për largimin, transferim apo ekuivalentim në këtë program. Nga takimi me stafin akademik të Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale u evidentua prirja rënëse relative në pranimin e studentëve.

Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 4.8: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit.

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para

Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se FSHS mbledh të dhëna statistikore që ndodhen në Sekretarinë Mësimore mbështetur në dokumentacionin ligjor të miratuar për këtë tipologji dokumentacioni.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

69

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e Universitetit. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të këtyrë të dhënave personale të studentëve prej universitetit, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Ne RVB rekomandohet që të kete nje proces analize dhe raportimi periodik dhe sistematik te të dhënave, për të vlerësuar dhe kuptuar realisht situatën me studentët dhe sektorët që ofrojnë shërbime kundrejt tyre dhe stafit. Këto të dhëna statistikore duhet të menaxhohen nga një strukturë e posaçme, e cila të jetë përgjegjëse për arkivimin dhe referimin e tyre në sektorët përgjegjës që kanë për detyrë të kujdesen për mbarëvajtjen dhe cilësinë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB,1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 4.8: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se sistemi informatik, është instrumenti kryesor për dhënien e shërbimeve, duke lehtësuar, siguruar dhe përmirësuar edhe mbarëvajtjen e procedurave në sekretarinë mësimore të FSHS.</p> <p>FSHS mbështetur në rregulloret e miratuara, regjistron, ruan, përditëson dokumentacionin me të dhënat e studentëve të çdo programi ne përputhje me hapësirat ligjore përkatëse, Kodin e Etikës dhe respektimit e ruajtjes së privatësisë në administrimin e tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB,1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 4.8: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, 1.5 Kodi i Etikës, 2.9 rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se të dhënat statistikore të studentëve në Universitetin e Tiranës, menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, në formë elektronike, por edhe të shkruar. Sistemi informatik jo vetëm siguron ruajtjen e të dhënave duke respektuar privatësinë e të dhënave, por është një mjet efikas komunikimi mes pedagogëve, stafit administrativ dhe studentëve. Sektori i IT-së mundëson që të dhënat të jenë të përdorshme nga studentët elektronikisht, por edhe të printuara, sikurse jane lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar dhe me interes të veçantë për këto të dhëna. Rregulloret e posaçme rregullojnë kompetencat dhe detyrat e stafit dhe studentëve, duke krijuar lehtësi për marrjen e shërbimeve dhe ruajtjen e të dhënave. Gjithashtu, sektori i IT-së në FSHS, publikon informacionin e konsultuar dhe të nevojshëm, mbi bazën e kërkesave të ndryshme dhe nevojës për njoftime, informacion kundrejt transparencës, duke i bërë kështu edhe studentët pjesë të shpërndarjes së informacioneve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 4.8: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota</i></p>

	<i>mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, www.unitir.edu.al.</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se në zbatim të udhëzimit të MASR Nr. 5 datë 19.02.2018, çdo fund viti akademik, FSHS harton raporte vjetore analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Në raportin vjetor të universitetit, përfshihen raportet analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si edhe shkalla e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p>Në RVB jepen disa vlerësime për përmirësimin e punës në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për hyrjen e studentëve, orientimin, studimin e tregut si dhe gjurmimin e studentëve në tregun e punës. Një rol të rëndësishëm iu atribuohet rregullimeve të pritshme përmes konstituimit të Urdhërit të Punonjësit Social.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 4.8: Të dhëna të plota për rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe dalje për programin e studimi, 4.9: Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit, www.unitir.edu.al.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe tyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se bazuar në përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutin e UT-së studentët kanë të drejtë të përfshihen dhe angazhohen në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Në zbatim të Statutit të UT-së, përfaqësimi i studentëve bëhet në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit, në Senatit Akademik, Këshillin e Etikës me dy anëtarë, nga rradhët e studentëve, Komisionet e përhershme të lejuara me statut, si në Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të marrëdhënieve me studentët, me tre përfaqësues, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, me një përfaqësues, Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, me dy përfaqësues, apo në Këshillat e studentëve me synim mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, njëjësive bazë dhe kryesore, si edhe konfigurimin korrekt të marrëdhënieve me studentët.</p> <p>Përfaqësimi i studentëve si pjesë e komisioneve të përhershme, apo njëjësive të tjera kolegjiale të UT dhe FSHS, garanton përfshirjen e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, sipas akteve ligjore dhe rregullatore të IAL-së. Njëkohësisht studentët e UT-së mund të jenë sipas rastit, anëtarë të komisioneve ad-hoc, të ngritur në nivel Institucioni/Njësie Kryesore' Departamenti. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve, dhe përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse, është konkretizuar në zgjedhjet për anëtar të</p>

	<p>Bordit të Administrimit të Universitetit, për të cilin votojnë të gjithë studentët.  <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion nënvizojme se Statuti dhe Rregullorja e UT dhe FSHS përcaktojnë se studentët e UT kanë të drejtë që, përmes anketimeve të zhvilluara çdo vit mbi cilësinë e mësimdhënies nga personeli të UT, të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre mbi këto çështje: Rregullorja dhe Statuti i UT, garantojnë që studentët, në mënyrë përfaqësuese të përfshihen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik. Përzgjedhja e përfaqësuesve të studentëve realizohet përmes një procesi transparent, duke filluar me propozimet e kandidatëve dhe votimin dhe nxjerrjen e rezultatit. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtuese si, në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, në Këshillat e Fakulteteve ku janë të regjistruar, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Universitetit. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë, si edhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në universitet, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve, ne komisione ad hoc për çështje te veçanta te institucionit. Përmes realizimit të anketimit, konkretizohet e drejta e studentëve për t'u shprehur mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi që ndjekin, si edhe për punën e realizuar nga stafi i FSHS dhe DPPS. Rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve, pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimin të Pyetësorëve që përgatitet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional. Raporti diskutohet më pas në Njësinë Bazë, nga ku dalin sugjerimet konkrete për përmirësimin e gjetjeve të matura.  <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se për hartimin e programit Master Profesional Punë Sociale e Avancuar me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, janë konsultuar programe dhe praktika ndërkombëtare, por dhe plotësimet e vijueshme të legjislacionit dhe strukturave të shërbimeve sociale në institucionet shqiptare.  Programi është hapur bazuar në legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet e bëra në kurrikulat mësimore për përmirësimin e programit, janë realizuar duke mbajtur parasysh ndryshimet e bazës ligjore, si dhe përshtatjes së programit të studimit me nevojat e tregut të punës. Në vlerësimin e ngarkesës akademike të studentit janë mbajtur parasysh jo vetëm marrja e informacionit teorik, por edhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë përgjatë semestrit, sipas zërave të vlerësimin të vendosur në programet e lëndëve nga lektorët përkatës, ku</p>



	<p>përfshihen provimet e ndërmjetme, detyrat apo projektet e kursit dhe angazhimi aktiv në orët e seminareve dhe provimi përfundimtar. Është parashikuar, gjithashtu, edhe lehtësimi i procedurave të ndjekjes së përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme të studentëve, si në rastin e procedurave të ekuivalentimit dhe njohjes së lëndëve, të krediteve për studentët që transferohen (vijjnë nga jashtë universitetit dhe lëvizin brenda Fakultetit të Shkencave Sociale, duke ndryshuar degë), dhe rastet e ripranimit të studentëve me ndryshim planesh mësimore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentet në institucion konstatohet se Universiteti i Tiranës dhe FSHS në dokumentat bazë të tyre, përkatesisht Statuti dhe Rregullorja, garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta, dhe reflekton kontributin e tyre në to. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UT-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.</p> <p>Raporti i Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve përgatitet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional dhe është objekt diskutimi dhe reflektimi në njësinë bazë, lidhur me përfundimet e raportit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se Statuti i UT-së dhe Rregullorja parashikojnë të drejtën e studentit për të dhënë mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimit të rezultatit, përfundimin e studimeve, provimet dhe riprovimet, sikurse edhe përfundimin dhe regjistrimin e vlerësimit të studentëve në sistemin informatik, procese këto të rregjistruara në dokumentacionet përkatëse të sekretarisë mësimore</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korrigjimet e duhura. Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit, i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse Dekani e gjen të</p>

	<p>drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rihvillimin e provimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.</p> <p>Kjo procedurë, krijon mundësinë për studentin për të marrë informacion të plotë dhe të shpejtë për vlerësimin e tij. Nga ana tjetër, sistemi informatik, krijon mundësinë që për çdo ndërhyrje të lihet gjurmë për kohën, apo edhe numrin serial të kompjuterit prej nga është regjistruar vlerësimi. Pas periudhës së parashikuar në rregullore funksionimi i sistemit nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</p> <p>Në takim me Grupin e ekspertëve studentët konfirmuan se në praktikë problemet që mund të kenë pasur i kanë zgjidhur përmes paraqitjes së pretendimeve pedagogut pa pasur nevojë për të nisur procedurat e ankimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 2.27 Informacion për bazën rregullatore të ankimimit të studentëve, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vlerësojmë se Universiteti i Tiranës ka ngritur një sistem funksional informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedura në lidhje me veprimtari të ndryshme në kuadër të procesit mësimor. FSHS ofron shërbimin e informacionit për studentët përmes njësisë së Karrierës dhe Zyrës së Informacionit dhe kjo veprimtari e njësisë së Këshillimit dhe Karrierës realizohet në përputhje me statutin e UT. Faqja zyrtare e webit pasqyron të gjitha aktivitetet që zhvillohen në FSHS e si edhe nga departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta edhe në kuadër të programit të transparencës. Institucioni është mjaft aktiv dhe në rrjetet sociale. Institucioni përdor për komunikimin e brendshëm e-maillet zyrtare dhe platformën

	<p>Microsoft Teams.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 2.27 Informacion për bazën rregullatore të ankimimit të studentëve, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se në Universitetin e Tiranës funksionon një njësi e posaçme e informimit të studentëve dhe publikut në tërësi përmes Drejtorise së Marrëdhënies me Studentët dhe Marrëdhënies me Publikun. Informacioni i nevojshëm publikohet në forma të ndryshme: në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave etj, të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve. Në FSHS nëpërmjet ekraneve të instaluar afishohen në mënyrë të vazhdueshme informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin akademik dhe njoftime të tjera të fakultetit. Po ashtu, faqja zyrtare e fakultetit pasurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe publikohen informacione të nevojshme në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe programin e transparencës që FSHS zbaton.</p> <p>Për t'u ardhur në ndihmë studentëve të rinj FSHS dhe DPPS përditëson dhe publikon materiale dhe broshura informative, të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme për programin e studimit, infrastrukturën, personelin akademik, jetën studentore, dhe mjaft informacione të vlefshme për studentët dhe përfshirjen e tyre në veprimtaritë në Fakultet. Staf i akademik në funksion të ofrimit të asistencës së vazhdueshme për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në dispozicion të studentëve, ofron dhe shpall edhe orarin e takimeve në zyrë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 2.27 Informacion për bazën rregullatore të ankimimit të studentëve, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se Fakulteti i Shkencave Sociale ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, me strukturat e ngritura si shërbimi ndaj studentit, koordinatori i programit, etj. FSHS nëpërmjet njësisë së Këshillimit të Karrierës ofron në mënyrë të vazhdueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>📌 -Këshillim karriere</li> <li>📌 -Informacion mbi vende pune</li> <li>📌 -Informacion mbi praktikën profesionale</li> <li>📌 -Informacion në lidhje me trajnime dhe workshop</li> </ul> <p>Specialistja e Këshillimit të Karrierës është në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premte, në orarin 8.00- 16:30</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.15</i></p>

	<p><i>Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, 2.26: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative. 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, 3.17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale, 3.19 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, 3.21 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se njësia e Këshillimit dhe Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit MPSA dhe ua vë në dispozicion ato studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese sipas nevojës. Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore mban kontakte me studentët e diplomuar përmes email-it, numrave të kontaktit përmes telefonit dhe rrjeteve sociale dhe përpunon të dhënat për punësimin e tyre dhe i paraqet në formën e relacioneve rregullisht. Gjithashtu GVJ konstatoi se FSHS paraqet informacione për veprimtaritë e zhvilluara me Alumni, publikon të dhëna për Alumni dhe Formularin e Alumnit.</p> <p>Në raportin e GVB përcaktohet se sfida për njësinë e Këshillimit dhe Karrierës është vendosja e bashkëpunimit sistematik me subjekte që operojnë në tregun shqiptar si dhe bashkëpunimi me Urdhrin e Punonjësit Social për të ndërtuar një bazë të dhënash të vazhdueshme, me qëllim ndërtimin e politikave afatgjata në lidhje me karrierën e studentëve pas diplomimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet, dhe provimet, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, 3.21 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale, 4.14 Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve të rprogramit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se UT e percakton Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Universiteti i Tiranës, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 dhe Statutit të UT si dhe në përmbushje të misionit të tij, përpiqet të sigurojë për stafin dhe studentët shërbime cilësore në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Për këtë qëllim UT po punon për të ngritur e konsoliduar një sistem efektiv të sigurimit të cilësisë, i cili udhëheq veprimtarinë akademike dhe funksionet administrative në institucion.</p> <p>Në përputhje me detyrimin ligjor, institucioni ka hartuar politika dhe dokumentat përkatëse, të cilat kanë gjetur zbatim përmes procedurave dhe instrumentave transparente të rëndësishme, për të drejtuar dhe orientuar punën e strukturave të posaçme edhe me pjesëmarrjen e studentëve, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Vlerësimi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i përgjithshëm ose pjesor, kryhet jo më pak se një herë në gjashtë vite, por mund të kryhet edhe më shpesh, nëse shihet e arsyeshme.</p> <p>Më konkretisht, në Statutin e Universitetit të Tiranës parashtrohet se Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni, përmes ngritjes së strukturave dhe funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Statuti parashikon ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni dhe Njësie Kryesore, ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve detyrat dhe përgjegjësitë. Politikat e ngritura prej institucionit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, realizohen nëpërmjet një sërë instrumentash që parashikohen në Rregulloret e Institucionit. Referuar këtyre dokumentave, janë parashikuar strukturat, parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe ngritja në njësitë kryesore të UT dhe funksionimi i Njësive të Vlerësimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJVSBC), përbërja e të cilave përcaktohet nga vetë njësitë kryesore dhe duhet të përfshijë edhe përfaqësues të studentëve. Në rregulloret e institucionit parashikohen politikat e nevojshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentash.</p> <p>Mbështetur në Planin Strategjik të UT dhe Strategjinë e FSHS dhe DPPS për përmirësimin e cilësisë në të gjitha veprimtaritë që universiteti kryen, politikat dhe masat operative që propozohen si pjesë e kësaj strategjie, e drejtojnë UT, e për rrjedhojë edhe FSHS dhe DPPS, në mënyrë të qëndrueshme, në përmbushjen e objektivave të përcaktuara si dhe hartimin e objektivave të reja në përputhje me dinamikën e zhvillimit të UT.</p> <p>Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme organet kolegjiale të institucionit, kanë miratuar procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku përshkruhet në mënyrë të hollësishme procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizës së rezultateve të pyetësoreve, deri tek plani i masave, që propozohet për përmirësimin, vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë jetës studentore në UT, FSHS dhe DPPS, prej strukturave mbështetëse për programet e studimit, vlerësimin e performancës akademike të stafit me kohë të plotë e të pjesshme si dhe</p>

	<p>personelit ndihmësakademik, sipas Vendimit Nr.51, datë 23.12.2020, “Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës”.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë UT ka ngritur strukturat e nevojshme në nivel institucioni e fakulteti, në të cilat garantohet përfshirja e stafit dhe studentëve. Në rrugën e konsolidimit si struktura të reja, ato janë në proces përmirësimi, përpilimi të rregulloreve. Krijimi dhe vijimësia e punës, në zbatim të këtyre dokumenteve, përbëjnë njëkohësisht edhe një prej objektivave strategjikë të Universitetit dhe për rrjedhojë edhe të FSHS. Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, me përbërje personel ndihmësakademik, një drejtor, një përgjegjës dhe 2 specialistë.</p> <p>NJSBC e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, gjithashtu Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, Manualin për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, Statutin e UT-së, në vendime të Senatit, etj. NJSBC ka hartuar Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, si dhe në përputhje me këtë kuadër ligjor dhe administrativ janë ngritur Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni. Sipas RVB po punohet për plotësimin me anëtarë dhe funksionimin aktiv të tyre për të zbatuar politikën e UT, për garantimin e përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe ngritjen e kulturës së cilësisë në UT.</p> <p>Për rrjedhojë në Fakultetin e Shkencave Sociale është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FSHS, veprimtaria e të cilës ka qenë e fokusuar, para së gjithash, në hartimin e planit të masave për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Kjo njësi ka prodhuar dokumente që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë së brendshme dhe analizat përkatëse.</p> <p>Gjithashtu studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim opinion i tyre mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike/ ndihmësakademik dhe programeve mësimore që ofron UT.</p> <p>Në komisionet e përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni studentët përfaqësohen me një anëtar në çdo komision. Ata, gjithashtu, janë anëtarë në komisione të ndryshme ad-hoc, të ngritura me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</p> <p>Për më tepër, si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nepermjet organizimit të tryezave të rumbullakta, në</p>

	<p>aktivitete të rëndësishme dhe të dobishme, për trajnimin profesional të stafit ndihmësakademik, administrativ, studentëve. Për këtë bashkëpunim ka punuar Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës dhe Qendra për Drejtësi dhe Transformim në kuadër të UT. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është përmirësimi i kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet ndarjes së përvojave me të gjithë aktorët bashkëpunëtorë të përfshirë në to.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se dy prej instrumentave kryesorë për sigurimin e cilësisë në UT janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i Programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për çdo IAL sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015.</p> <p>Në vitin 2018, Universiteti i Tiranës realizoi vlerësimin e jashtëm institucional me qëllim përcaktimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, që ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Grupi i vlerësimit të jashtëm ishte i përbërë prej ekspertëve të huaj dhe vendas. Procesi i akreditimit të parë institucional të UT-së përfundoi me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 1 (një) vit akademik.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, pas përfundimit të procesit të akreditimit, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej GVJ, me Vendim të Senatit Akademik, është miratuar grupi i punës për përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se Universiteti i Tiranës me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka ndjekur një politikë të qartë dhe zbaton procedura periodike. Në Statutin e UT përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen; edhe në rregulloren e UT parashikohen instrumentat e kërkimit dhe procedurat, që duhet të ndjekë institucioni, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet një sërë instrumentash.</p> <p>Gjithashtu në mënyrë periodike, nëpërmjet NJSBC, në përfundim të çdo semestri akademik, para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor</p>

	<p>për cilësinë e mësimdhënies, për lëndët e çdo programi studimi. Për këtë qëllim me vendim të Senatit Akademik është miratuar edhe procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizës të rezultateve të pyetësoreve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p> <p>Qëllimi i këtyre politikave dhe procedurave ka qenë dhe është krijimi i kulturës së cilësisë në nivel institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit duke garantuar përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm të UT-së në këtë politikë dhe në këto procedura.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet pjesësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se UT ka ngritur struktura/sectorë me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit. Njësia kryesore që realizon Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përmes strukturës së posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni, pjesë e strukturës organizative të UT është Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, me sektorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori i Kurrikulave</li> <li>• Sektori i Sigurimit të Cilësisë</li> </ul> <p>Përgjegjësia e kësaj strukture ka të bëjë me ndjekjen dhe zbatimin e bazës ligjore në fuqi që nga hapja, riorganizimi apo mbyllja e programeve të studimit. Gjithashtu, në nivel institucioni dhe njësie kryesore, janë parashikuar ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Përhershme si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (me tej KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm të Kurrikulës (me tej KPK).</p> <p>Për më tepër, në nivel fakulteti, zv.Dekanët për anën akademike, kanë detyrë që në bashkëpunim me dekanatin e fakultetit të mbështesin dhe orientojnë politikën për zhvillimin e monitorimin e programeve të studimit që ofrohen prej Fakultetit të Shkencave Sociale.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

80




	<p><i>cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se UT perdor mekanizma dhe procese formale dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vijueshëm të programeve të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij</li> <li>■ Raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij</li> </ul> <p>Në DPPS procedura për ndryshime në programet e studimit, planet mësimore apo syllabuse, miratime të programeve të studimit bëhet referuar ndryshimeve në bazën ligjore (ndryshime në ligj, VKM, urdhëra, udhëzime prej MASR), apo ndryshime në përshtatje me kohën dhe kërkesat e tregut të punës, e kështu vepohet edhe për programin e studimit MPPSA.</p> <p>DPPS propozon mbi ndryshimet e mundshme të programit mësimor dhe i përcjell më tej në Senatit Akademik për miratim dhe sipas rastit (në se janë ndryshime me më pak se 20% apo me më shumë se 20%) është njoftuar ministria, ose është përcjellë për marrjen e miratimit prej saj. Në shërbim të procesit të përmirësimit të programeve të studimit të ciklit të dytë shërben pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, që realizohet në përfundim të çdo semestrit të vitit akademik, para sezonit të provimeve. Në përfundim të tij, hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënësit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë sociale.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se në FSHS dhe DPPS, nga Njësia e Vlerësimit dhe Sigurimit të Cilësisë, e ngritur me vendim të Dekanatit të FSHS është zhvilluar anketimi i studentëve për procesin e vlerësimit të pedagogëve të jashtëm, duke filluar nga semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Metodologjia e studimit ka qenë sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësori, i miratuar me Vendim të Senatit Akademik i paraqitur në Paketën e Instrumenteve të Sigurimit të Cilësisë. Pyetësori është i përbërë nga pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura. Opinione të studentëve mbi pyetjet e hapura janë dhënë për çdo pedagog që ka dhënë mësim në programin e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19, pyetësori është shpërndarë dhe administruar përmes platformës Microsoft Teams, ku edhe zhvillohej procesi mësimor online. Pjesëmarrës në studim kanë qenë të gjithë studentët, të cilët kanë ndjekur programin e studimit Master Profesional Punë Sociale</p>


	<p>e Avancuar, të cilët kanë një llogari personale në sistemin elektronik të Universitetit dhe që kanë frekuentuar qoftë dhe një lëndë të vetme përgjatë vitit akademik. Një student vlerëson të gjitha lëndët ku ka marrë pjesë gjatë vitit akademik.</p> <p>Raporti i Analizës së Pyetësorit, në vitin akademik 2020-2021, përpos përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura të pyetësorit, synonte gjithashtu edhe realizimin e një analize krahasuese, midis përgjigjeve të studentëve në lëndë të ndryshme brenda të njëjtës pyetje, sikurse edhe midis rezultateve të vitit akademik 2020-2021, në raport me një vit më parë, duke evidentuar ato pyetje ku ka ndryshime të dukshme. Rezultatet e këtij pyetësi shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>UT ka krijuar dokumente me qëllim vlerësimin e stafit akademik, të cilat gjejnë zbatimin e duhur përmes Manualit të Vlerësimit të Performancës së Stafit Akademik të UT-së, e miratuar në vitin 2021 nga Senati i Ut-së, që shërben si instrument potencial, për sigurimin e cilësisë brenda UT-së</p> <p>UT-ja në zbatim të dokumentit të sipërcituar, çdo vit realizon vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe ndihmësakademik e administrativ në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe fakultetet sipas formatit të miratuar me vendim të Senatit të UT.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 3.6 Rregullore e programit MPPPSA, 4.3 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional Punë sociale.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se duke u nisur nga procedura e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UT, FSHS, DPPS, miratuar me Vendim Senati Nr. 30.datë 22.07.2021, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, përmes Sektorit të Sigurimit të Cilësisë, përpos raportit të analizës, përpilon dhe projekt propozimet dhe ; rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke i përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse, procedura këto të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej DKSC-së, ju përcillen Njësisë Kryesore, të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë në çdo departament me stafin akademik, duke e bërë të gjithë procesin e përmirësimin të programit të</p>

	<p>studimit, nëpërmjet pyetësorit të studentëve transparent dhe gjithëpërfshirës. Njësitë kryesore dhe bazë diskutojnë rezultatet respektive, duke dhënë propozime përkatëse, të cilat diskutohen në mbledhjen e Rektoratit. Në Rektorat përpilohet plani i rinasave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënien, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit procedurë që është qartësisht e parashikuar dhe miratuar përmes vendimeve të Senatit të UT-së, por periudha e pandemisë e ka vështirësuar procesin e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimin e tyre, jo vetëm për shkak të mospërdorimit të platformës elektronike nga të gjithë studentët, por edhe për shkaqe psikologjike, që lidhen me uljen e vëmendjes ndaj produkteve cilësore nga studentët, të cilët u detyruan të ndërpresin kontaktet me auditorët, duke humbur mjaft edhe interesin për vlerësimin e stafit dhe shërbimeve që ata kishin pritshmëri të merrnin.</p> <p>Vlerësohet në RVB se përmirësimi i situatës, do të mundësojë një proces të plotë dhe transparent në të gjitha hallkat, sikurse edhe një përkushtim nga ana e NJVSC dhe FSHS, për të patur përgjigje reale mbi situatën dhe rekomandimet për përmirësimet e nevojshme.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="616 1055 770 1126">Përbashet në nivelin</th> <th data-bbox="770 1055 979 1126">Përbashet kryesisht</th> <th data-bbox="979 1055 1386 1126">Përbashet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="616 1126 770 1171"></td> <td data-bbox="770 1126 979 1171"></td> <td data-bbox="979 1126 1386 1171" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përbashet në nivelin	Përbashet kryesisht	Përbashet plotësisht			<b>X</b>
Përbashet në nivelin	Përbashet kryesisht	Përbashet plotësisht					
		<b>X</b>					
<b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>							
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>						
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vëmë në dukje se FSHS në funksion të zhvillimit dhe ecurisë së programeve të studimit, si dhe diplomimit të studentëve, ka hartuar dokumente referues. Duke marrë në konsideratë kontekstin e procesit të akreditimit në Universitetin e Tiranës, Raporti i Vetëvlerësimit i përpiluar prej Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në nivel institucioni ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për NJVSC dhe strukturat e institucionit të angazhuara në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Për më tepër çdo fund viti akademik Universiteti i Tiranës, përpilon Raportin Vjetor sipas Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. Në këtë raport pasqyrohet veprimtaria institucionale duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. Kjo analizë e hollësishtme, është një pikë referimi kyçe, për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet dhe kriteret ligjore, si dhe për të evidentuar mangësitë dhe masat që duhet të ndërmerren për ndreqjen e tyre.</p>						

	<p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se në kuadër të politikave, dokumenteve bazë të Universitetit të Tiranës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si dhe instrumentave përkatës me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në sektorin përkatës të Sigurimit të Cilësisë, përpilon raportin e analizës së pyetësorëve, i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport, shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore dhe bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Ne RVB nenvizohet se referuar natyrës dhe specifikës së kërkimit (vlerësimi i cilësisë së programeve akademike), për kryerjen e vlerësimit, Universiteti i Tiranës, ka përdorur metodën sasiore si një metodë e përshtatshme dhe instrumenti i përdorur është pyetësori.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion evidentojmë se referuar natyrës së programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional Punë Sociale e Avancuar” në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së këtij programi studimi, janë përdorur disa metoda të drejtpërdrejta duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës në mstitucione</p> <p>Në fillim të vitit akademik në DPPS Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit, kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e kurrikulave, syllabuseve etj. Në syllabuse pasqyrohen edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tij. Realizimi fizik i leksioneve dhe seminareve ka mekanizëm kontrolli në FSHS, për të siguruar realizimin maksimal të programit të planifikuar nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm në FSHS. Të gjitha këto çështje diskutohen në departament. Me qëllim mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimi, strukturat përgjegjëse në njësitë kryesore dhe bazë duhet të ushtrojnë më tepër kontroll, vëzhgime e metoda të tjera, për të garantuar tek studentët programe cilësore në tërësinë e komponentëve të tyre. Në fund të procesit të diskutimit, çdo anëtar i stafit të brendshëm, harton dhe nënshkruan</p>



	<p>marrëveshjen me përgjegjësin e departamentit, për shpërndarjen e punës dhe ngarkesave vjetore në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vëmë në dukje se UT ka të dhëna mbi shpërndarjen e profesionistëve të punës sociale, por edhe profilin gjeografik të studentëve aktualë, të shndërruar në profesionistë kërkues dhe aplikues, përfutues të vendeve të punës në zonat përkatëse, pas përfundimit të studimeve të nivelit të dytë.</p> <p>Për më tepër, DPPS është duke diskutuar ndërmarrjen e një studimi të fokusuar tek studentët e diplomuar në MPPSA me Drejtim Arsim dhe Shëndetësi, mbështetur edhe në Urdhrin e Punonjësit Social, me qëllim për të matur kërkesën dhe ofertën në tregun e punës në këto drejtime kyçe, të përcaktuara dhe aplikuar drejtpërdrejt në tregun e punës kryesisht në sektorin publik, por jo vetëm, sikurse edhe për të krijuar Memorien Alumni në MPPSA.</p> <p>UT, FSHS dhe DPPS kanë zhvilluar inisiativa për të mbërritur tek alumni, përmes projekteve të vogla dhe të pafinancuara kërkimore, por rezultati mbetet ende i përcaktuar, për faktorë teknikë, burimesh njerëzore, dobësi të sektorit të kërkimit shkencor në të gjithë UT. Vitet e fundit nuk kanë qenë favorizuese për nxitjen e zbatimit të çdo procedure, për shkaqe të njohura zyrtarisht (tërmeti dhe pandemia), por padyshim, përtej nevojave për vlerësim, DPPS, në funksion të MPPSA mendon se ka nevojë të mësojë nevojat e tregut të punës për profesionistë, shpërndarjen gjeografike të tyre, për të krijuar një bazë të vlefshme, që do të justifikojë dhe mbështetë planifikimet që departamenti bën lidhur me kuotat e pranimit, angazhimin e stafit të brendshëm e të jashtëm në realizimin e planit mësimor, si dhe marketimin e programit përtej FSHS dhe UT. Informacioni i përpunuar nga Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit, Zyra e Karrierës, mbështetet në dokumentat bazë të FSHS. Statistikat mbi punësimin e studentëve dhe lloji i punës (pozicionit drejtues) dhe karriera e tyre, janë një tregues mbi cilësinë e programeve të studimit të ofruar prej FSHS. Mbledhja e informacionit për alumni, mbetet ende një problem, për të cilin duhet të punohet akoma dhe më shumë. Mungesa e një baze me të dhëna, me të dhënat gjurmuese të ish studentëve është pengesa kryesore, në drejtim të të cilës duhet që strukturat në UT dhe FSHS të punojnë së bashku, për të ngritur këtë sistem aq të rëndësishëm për UT/FSHS/DPPS për sot dhe në të ardhmen.</p> <p>GVJ dhe RVB vleresojnë se ngritja e Urdhrit të Punonjësit Social, do të mundësojë një bankë të sigurtë të dhënash, të specifikuar statistikiqisht dhe të mundshme për t'u përpunuar lehtësisht, për numrin e të diplomuarve të punësuar, tipologjinë e punësimit, nivelin e kualifikimeve në vijim, sikurse edhe rastet e profesionistëve më të suksesshëm. Organizimi i takimeve me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni është praktikë vijuese në FSHS dhe DPPS. Qëllimi i këtyre aktiviteteve, workshope-ve, takimeve,</p>



	<p>është përmirësimi i kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet ndarjes së përvojave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni. Megjithatë opinioni i personelit akademik, ndihmës akademik e administrative merret në konsideratë gjatë mbledhjeve të ndryshme që realizohen në institucion, mungon një instrument, i cili do të mundësonte vjeljen e një infomacioni në mënyrë më sistematike (si psh. pyetësor). GVB e vlerëson këtë mundësi, si një pritshmëri të realizueshme në vijim të punës së tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020. 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, www.unitir.edu.al</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Zbatimi i politikave përmes procedurave korrekte, i jep mundësi UT, FSHS dhe DPPS që të krijojë më shumë partneritete të dobishme që ndikojnë dhe nxitin përmbushjen e objektivave strategjike sipas fushave, promovimin më të mirë të UT dhe FSHS, nga ku përfiton edhe programi MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, duke garantuar cilësi në metodologjitë e krahasuara të mësimdhënies dhe qasjeve globale në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera, të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. GVB mendon që komisioni i NJVSC-së në fakultet, duhet të funksionojë më</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

86

	<p>aktivisht, për të zbatuar politikat universitare, në garantimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke prodhuar sistematikisht produkte të punës së dokumentuar dhe transparencë, sikurse edhe Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 dhe Statuti i UT e përcakton. Pjesë e këtyre proceseve janë edhe procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e NJVSC-së në UT dhe FSHS edhe në lidhje me programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se plotësimi i këtij kriteri parashikohet me ngritjen në nivel fakulteti, të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në të cilin përpos stafit akademik të brendshëm, ka edhe përfaqësimit studentor (një student), por ky komision i ngritur tashmë, ende nuk është në pozita të mirëfillta të ushtrimit të detyrave e përgjegjësi, edhe për shkak të copëtimit të vijueshëm që ka pësuar procesi mësimor që nga semestri i parë i vitit 2019 e deri në përfundim të vitit akademik 2021. Më shpesh ka qenë i pranishëm roli i Dekanatit, i cili ka qenë orientues dhe nxitës për nisma lidhur me proceset vlerësuese, por që realisht, edhe pse mbështet dhe orienton politikën për zhvillimin e monitorimin e ofertës akademike të fakultetit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, ky komision ende nuk është mjaftueshëm aktiv në lidhje me kërkesat për dokumentacionin e duhur të prodhuar nga NJVSC në FSHS. Të gjitha hallkat drejtuese e kolegjiale në përputhje me hierarkinë insituacionale duhet të shohin dhe analizojnë situatën, në mënyrë që në kushtet e normalizimit të procesit të mësimdhënies dhe strukturës së vitit akademik, të plotësojnë rolet dhe detyrimet përkatëse në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji i Arsimin të Lartë Nr. 80/2015 dhe Statuti i UT.</p> <p>Një tregues që siguron përfshirjen e studentëve është pyetësori i organizuar prej NJVSC në fund të çdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë. Në këtë proces studentët përfshihen jo vetëm në plotësimin e pyetësorit, por nxiten të plotësojnë Pyetësorin për Studentët për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies, të marrin pjesë në Sondazhin Kombëtar të studentëve, në grupe të ndryshme të ngritura me qëllim përpilimin ose rishikimin e instrumentave të vlerësimit të brendshëm, por edhe si aktorë aktivë në procesin e ngritjes së kulturës së cilësisë, duke i përgatitur për t'u angazhuar në fushatat informuese dhe promovuese mbi rëndësinë e përfshirjes së studentëve në politikën e vlerësimit të UT dhe FSHS e më tej në programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS</i></p>

	2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a> .
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se gjate zbatimit të instrumentave të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të përdorur prej strukturave përkatëse, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, është respektuar liria dhe etika akademike si dhe Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, reflektuar edhe në dokumente bazike të UT-së.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime, duke ruajtur konfidencialitetin e përgjigjeve të tyre. Nuk ka ndodhur në asnjë rast që studentët të ankojnë për shfaqje të dukurisë së diskriminimit apo pabarazisë. GVB vë në dukje se mungojnë raporte të shumë viteve, si produkte analitike të proceseve, dhe kjo nuk u jep shumë mundësi informacioni, kështu bazohen tek procedura administrative e shprehur në dokumentat themelore të UT-se.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.5 Kodi i Etikës i UT, 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a>.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me sektorët përkatës, KPVBC, po aq sa edhe Njësia bazë FSHS dhe NJVSBC në filozofinë e tyre, gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbështeten në përfshirjen e gjerë të grupeve të interesit, me qëllim mbledhjen e informacionit gjithpërfshirës, për të gjetur instrumentat e përshtatshëm për të kapërcyer sfidat, në arritje të modeleve më të mira të cilësisë akademike në funksion të programit MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi dhe sigurimin e shërbimeve më të mira për studentët.</p> <p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet ndarjes së përvojave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni, FSHS ka organizuar vazhdimisht takime, leksione të hapura dhe workshope me fokus studentët dhe tregun e punës. Në aktivitete kanë marrë pjesë alumni, të pozicionuar në vendimarrje dhe politikëbërje në qeverisjen vendore dhe dhe qendrore, deputetë, ministra, përfaqësues të OJF vendase dhe të huaja, ekspertë, përfaqësues të institucioneve jo publike, etj. Përpos informimit të nevojshëm për studentët dhe stafin, janë shkëmbyer ide që kanë nxitur rekomandime për përmirësimin e programeve të studimit dhe marrëdhënieve bashkëpunuese institucionale. Këto aktivitete janë dëshmi e përpjekjeve të DPPS për përfshirjen e të gjithë bashkëpunorëve në procesin e përmirësimit të cilësisë dhe megjithëse realizohet prej një kohë shumë të gjatë, përbëjnë një praktikë të dobishme të lidhur me cilësinë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësies së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna</i></p>



	<i>tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, www.unitir.edu.al.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se Universiteti i Tiranës, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike të Universitetit (Statuti, vendime të Senatit Akademik, vendime të Bordit të Administrimit, raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj), si dhe nëpërmjet dokumentave zyrtare tek të gjitha Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, duke kontribuar në krijimin e një institucioni të arsimit të lartë bashkëkohor, të hapur e transparent, me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij. Ajo që vlen të përmirësohet në të ardhmen, lidhet me raportimet e analizave të gjetjeve, të cilat përmes përpjekjes për t'i mbajtur parasysh dhe ndrequr mangësitë do të përmirësojnë ndjeshëm arkitekturën e shërbimeve në arritje të cilësisë së brendshme për programin MPPSA me drejtim Arsim dhe Shëndetësi, por edhe për DPPS, FSHS dhe UT.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018 "Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë" ky standard vjen i përmbushur nga FSHS kundrejt çështjes, përmes raportit të analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, për çdo lëndë të çdo programi studimi. Informacioni i publikuar në raport, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Raporti publikohet në nivel Njësie Kryesore, si një përmbledhje e përpunuar e raporteve përkatëse të çdo departamenti. Në</p>

	<p>zbatim të ligjit, UT-ja ka ndërmarrë dhe hartuar një sërë dokumentesh, instrumentesh, procedurash, për të përmbushur detyrimin e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale brenda institucionit dhe Njësive Kryesore dhe të drejtës për publikimin e tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8 Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.9 Privatësia në UT, 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.8 Informacion për respektimin e lirisë akademike dhe të autonomisë organizative dhe financiare, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësive të Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se sipas Procedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin e Tiranës, NJSBCVI, përpos Raportit të Analizës, përpilon dhe projektpropozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke i përcjellë më tej, pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Në përfundim të zbatimit të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e sipërcituar, përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. Pas miratimit prej këtij të fundit, Plani i Masave, publikohet në faqen UT-se, FSHS-së dhe monitorohet zbatimi i tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion vërejmë se RVB nënvizon se përmirësimi i vazhdueshëm i instrumentave të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, është një prej objektivave të Universitetit të Tiranës. Në dokumentat kryesore të FSHS-së për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, është vendosur ngritja e grupit të punës, në nivel institucional, me qëllim përmirësimin e pyetësorit të studentëve për cilësisën e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësive të Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se për ngritjen e kulturës së cilësisë, Institucioni dhe Njësia Kryesore, në përmbushje të procedurës, organizojnë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

90

dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>aktivitete dhe seminare informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes të vetëdijshme në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion (si për shembull plotësimi i pyetësorëve, pjesëmarrja në Sondazh Kombëtar për Studentët, etj. Më specifikisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore</li> <li>✦ Publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të Universitetit.</li> <li>✦ Publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në Sistemin e Informacionit të UT-së, platformat online.</li> <li>✦ Programeve të shkëmbimit në kuadrin e projekteve të ndryshme ndërkombëtare</li> </ul> <p>Periudha e mësimdhënies online në kushtet e pandemisë Covid-19, e reduktoi masivisht komunikimin e drejtpërdrejtë me studentët si dhe numrin e aktiviteteve të tilla. Ndërkohë, njoftimi informimi dhe komunikimi ndërgjegjësuës, është kryer nga stafi akademik i brendshëm, i cili u njoftua për periudhën e realizimit të vlerësimit dhe bëri shpërndarjen e pyetësorëve përmes platformës Microsoft Teams tek studentët respektivë, sipas lëndëve që mbulonte.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.11 Manuali i cilësisë, 1.14 Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Politika e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, 2.17 Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel FSHS, 2.18-1 Analiza vjetore e punës së FSHS 2020-2021, 2.18-2 Analiza vjetore e punës së FSHS 2019-2020, www.unitir.edu.al.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional në "Punë Sociale e Avancuar" me profile: Punë Sociale në Arsim; Punë Sociale në Shëndetësi të Institucionit të Arsimit të Lartë, "Universiteti i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime**


1. Universiteti i Tiranës përfaqëson markën më të njohur dhe më të kërkuar në nivelin universitar dhe pasuniversitar për arsye se përfaqëson IAL e parë në Shqipëri, më të hershëm nga përvojë, tradita dhe cilësia që ka krijuar.
2. UT-ja në dokumentet bazë të veta, shpreh angazhimin për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik, duke inkurajuar kërkim shkencor, promovimin dhe trajnimin e personelit akademik në universitetet perëndimore me të cilat ka lidhur marrëveshje për shkëmbim të stafit akademik për trajnime dhe mësimdhënie.
3. Fakulteti i Shkencave Sociale përfaqëson një institucion me shumë rëndësi universitare dhe kërkimore shkencore në fushën e Shkencave Sociale
4. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale është departamenti me më shumë përvojë në FSHS
5. Programi Master Profesional Punë Sociale e Avancuar me dy profile: Shëndetësi dhe Arsim ka krijuar profilin e vet të qëndrueshëm në tregun e punës, që dëshmohet nga ecuria dhe qëndrueshmëria e tij.
6. Në këtë program studimi ka disa titullarë lëndësh me kualitet të lartë akademik dhe aplikativ.
7. Ka rishikimet e nevojshme të disa prej syllabuseve për t'i përafuar ato me realitetin dhe zhvillimet në administrimin e biznesit në Shqipëri.
8. Ka prani të evidentuar mediatikisht në forume, konferenca dhe takime të cilat iu mundësojnë stafit akademik të këtij programi të kenë kontakte, të marrin përgjigje apo shkëmbejnë ide me ekspertë të fushës vendas apo të huaj.
9. Vendodhja e FSHS është një pikë e fortë për shkak të afërsisë me institucionet kryesore në vend dhe mbulohet lehtësisht nga transporti publik.
10. Shumë aktiv në lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve konkrete me IAL të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
11. FSHS dhe DPPS kanë ndërtuar një praktikë shumë pozitive bashkëpunimi me studentët për zgjidhjen e problemeve që shfaqen.
12. UT dhe FSHS përmes politikave dhe procedurave kanë krijuar kulturën e cilësisë në nivel institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit duke garantuar përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm të UT-së në këtë politikë dhe në këto procedura.

## Pika të dobta

1. Lidhur me mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët në takimet e zhvilluara dhe nga RVB deri tani, financimi në nivel institucioni ka qenë modest. **(Standardi 3/7 Kriteri 9).**
2. Nga takimi në FSHS u evidentua se sfida e DPPS është të vendosë bashkëpunime me subjekte të ndryshme që operojnë në tregun shqiptar duke organizuar një sërë aktivitete gjatë vitit akademik, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët e FSHS-së **(Standardi V.3.3).**
3. Mungon një instrument për tërheqjen e opinionit të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative **(Standardi VI.3.4).**
4. Nevojitet që të ketë një proces analize dhe raportimi periodik dhe sistematik të të dhënave, për të vlerësuar dhe kuptuar realisht situatën me studentët dhe sektorët që ofrojnë shërbime kundrejt tyre dhe stafit. Këto të dhëna statistikore duhet të menaxhohen nga një strukturë e posaçme, e cila të jetë përgjegjëse për arkivimin dhe referimin e tyre në sektorët përgjegjës që kanë për detyrë të kujdesen për mbarëvajtjen dhe cilësinë **(Standardi V.4.2).**
5. Nevoja e ngutshme për ngritjen e një laboratorit të mirëfilltë ITC, që do t'u shërbejë më mirë studentëve, edhe atyre të MPPS për realizimin e detyrave apo projekteve, individuale apo në grup **(Standardi IV.3.4).**
6. Moduli për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit ende nuk është pjesë e platformës së menaxhimit të informacionit **(Standardi IV.5.1).**

## Rekomandime

1. Marrja e masave prej strukturave përgjegjëse, për të shtuar fondin e librave me tituj të rinj bashkëkohorë, në funksion të programit të studimit, sikurse edhe realizimin e iniciativave për përkthime të literaturës së sugjeruar, në mënyrë që studentët të shfrytëzojnë sa më shumë literaturë, edhe të mund të përdorin më shumë dhe lehtësisht leksione në gjuhën shqipe.
2. Referuar dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara rezultojnë se praktika profesionale realizohet pranë institucioneve publike, apo në sektorin privat të nivelit lokal apo kombëtar. Praktikën profesionale realizohen në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe ato individuale të studentit.
3. Për këtë qëllim shërben dhe *Udhëzuesi i Praktikave*, i cili parashikon në mënyrë të qartë modalitetet dhe afatet kohore të kryerjes së praktikave mësimore, procesin e organizimit të praktikave, udhëheqësit e praktikave, mënyrën e vlerësimit të tyre.
4. GVJ sugjeron se në përmbushje të objektivit të programit për të përgatitur profesionistë në këtë fushë që të jenë konkurrues në tregun ndërkombëtar, Institucioni mund të rishikojë mundësinë për të ofruar lëndë në gjuhën angleze; kjo do të ishte një mundësi përthithje e studentëve të huaj.



5. Pavarësisht zotërimit të rregulloreve dhe udhëzuesve të ndryshëm për aspekte dhe situata të caktuara të mësimdhënies, FSHS/DPPS i ka të gjitha kapacitetet pedagogjike për të hartuar në të ardhmen një udhëzues në nivel institucional dedikuar zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve që ofron.
6. Njësia e Këshillimit dhe Karrierës duhet të vendosë bashkëpunim sistematik me subjekte që operojnë në tregun shqiptar si dhe bashkëpunimi me Urdhrin e Punonjës Social për të ndërtuar një bazë të dhënash të vazhdueshme, me qëllim ndërtimin e politikave afatgjata në lidhje me karrierën e studentëve pas diplomimit
7. Marrja e masave prej strukturave përgjegjëse, për të shtuar fondin e librave me tituj të rinj bashkëkohorë, në funksion të programit të studimit, sikurse edhe realizimin e iniciativave për përkthime të literaturës së sugjeruar, në mënyrë që studentët të shfrytëzojnë sa më shumë literaturë, edhe të mund të përdorin më shumë dhe lehtësisht leksione në gjuhën shqipe.
8. Digjitalizimi i standartizuar dhe i unifikuar i librit dhe tekstit mësimor në UT dhe FSHS mbetet detyrë për t' u realizuar në të ardhmen.
9. Nevojitet përmirësimi i punës në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për hyrjen e studentëve, orientimin, studimin e tregut si dhe gjurmimin e studentëve në tregun e punës.

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master's study program in 'Advanced Social Work' with profiles: Social Work in Education; Social Work in Health of the Institution of Higher Education, "University of Tirana"**


**Strengths and Affirmations**

1. The University of Tirana represents the most well-known and sought-after brand at the university and postgraduate level for the reason that it represents the first HEI in Albania, the earliest in terms of experience, tradition and the quality it has created.
2. UT, in its basic documents, expresses its commitment to the continuous qualification and further professional development of academic staff, encouraging scientific research, promotion and training of academic staff in Western universities with which it has concluded staff exchange agreements academic for training and teaching.
3. The Faculty of Social Sciences represents an institution of great university and scientific research importance in the field of Social Sciences
4. The Department of Labor and Social Policy is the department with the most experience in FSHS

5. The Professional Advanced Social Work Master's program with two profiles: Health and Education has created its own stable profile in the labor market, which is proven by its progress and stability.
6. In this study program there are several subject holders with high academic and applied quality.
7. There are the necessary revisions of some of the syllabuses to align them with reality and developments in business administration in Albania.
8. There is media evidenced presence in forums, conferences and meetings which enable the academic staff of this program to have contacts, receive answers or exchange ideas with local or foreign experts in the field.
9. The location of FSHS is a strong point due to its proximity to the main institutions in the country and is easily covered by public transport.
10. Very active in concluding concrete agreements and collaborations with other homologous HEIs inside and outside the country.
11. FSHS and DPPS have built a very positive practice of cooperation with students to solve the problems that arise.
12. UT and FSHS, through policies and procedures, have created the quality culture at the institutional level, of the constituent units and all the internal actors of the institution, guaranteeing the involvement of all the internal actors of the UT in this policy and in these procedures.

### Weak points


1. Regarding the support and development of innovative ideas, advanced research and scientific studies by students in the meetings held and by RVB until now, funding at the institution level has been modest. **(Standard 3/7 Criterion 9).**
2. From the meeting at the FSHS, it was evident that the challenge of the DPPS is to establish cooperation with various entities that operate in the Albanian market by organizing a series of activities during the academic year, which are directly related to the students of the FSHS **(Standard V.3.3).**
3. There is no instrument for attracting the opinion of the academic, academic and administrative staff **(Standard VI.3.4).**
4. It is necessary to have a periodic and systematic data analysis and reporting process, to evaluate and really understand the situation with students and the sectors that provide services to them and the staff. These statistical data must be managed by a special structure, which will be responsible for archiving and referring them to the responsible sectors that have the duty to take care of the progress and quality **(Standard V.4.2).**



5. The urgent need for the establishment of a real ITC laboratory, which will better serve students, including those of the Ministry of Education and Culture, for the realization of tasks or projects, individual or in a group (**Standard IV.3.4**).
6. The module for the administration of information, documentation and activity of academic staff, academic support staff, administrative staff and partners engaged in the implementation of the program is not yet part of the information management platform (**Standard IV.5.1**).

### Recommendations

1. Taking measures by the responsible structures to increase the fund of books with new contemporary titles, in function of the study program, as well as the implementation of initiatives for translations of suggested literature, so that students can use as much literature as possible. , even to be able to use more and easily lectures in the Albanian language.
2. Referring to the documentation and meetings held, it results that professional practice is carried out near public institutions, or in the private sector at the local or national level. Professional internships are carried out in accordance with the objectives of the study program and those of the individual student.
3. For this purpose, the Internship Guide serves as well, which clearly provides the modalities and time limits for the implementation of teaching practices, the process of organizing the practices, the leaders of the practices, the way of their evaluation.
4. GJV suggests that in fulfilling the objective of the program to prepare professionals in this field to be competitive in the international market, the Institution may review the possibility of offering courses in English; this would be an opportunity to absorb foreign students.
5. Despite the possession of different regulations and guidelines for certain aspects and situations of teaching, FSHS/DPPS has all the pedagogical capacities to draft in the future a guide at the institutional level dedicated to the development and use of different and innovative methods of teaching based on the field of studies it offers.
6. The Counseling and Career Unit should establish systematic cooperation with entities operating in the Albanian market as well as cooperation with the Order of Social Workers to build a continuous database, with the aim of building long-term policies regarding the career of students after graduation
7. Taking measures by the responsible structures to increase the fund of books with new contemporary titles, in function of the study program, as well as the implementation of initiatives for translations of suggested literature, so that students can use as much literature as possible. , even to be able to use more and easily lectures in the Albanian language.
8. The standardized and unified digitization of books and textbooks in UT and FSHS remains a task to be carried out in the future.
9. There is a need to improve work in the collection and processing of data for student entry, orientation, market research and tracking.





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

